



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 58

Tiranë – E enjte, 25 prill 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 22/2019 datë 3.4.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 103/2016 “Për akuakulturën” 4563
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 24.4.2019	Për përcaktimin e rregullave të funksionimit të Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe për masën e shpërblimit për veprimtarinë e anëtarëve..... 4564
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 245, datë 24.4.2019	Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë të nëpunësve dhe punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës..... 4565
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3/1, datë 15.4.2019	Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të Fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural..... 4568
Urdhër i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 112, datë 19.4.2019	Për delegim të përkohshëm kompetencash..... 4622
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 5738, datë 17.4.2019	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje dypalëshe me Filipinet..... 4622
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen e vdekjes së shtetasit Bahri Toçilla.. 4623
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Kujtim Sema..... 4623



LIGJ
Nr. 22/2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE
SHTESA NË LIGJIN NR. 103/2016
“PËR AKUAKULTURËN”¹

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 7, fjalia e parë ndryshohet si më poshtë:

“Zonë e përcaktuar për akuakulturë (ZPA)” është një sistem planifikimi hapësinor apo zonimi, i kryer në nivel rajonal ose kombëtar.”

2. Pas pikës 18 shtohet pika 19 me këtë përmbajtje:

“19. “Instalime në pronësi shtetërore” është tërësia e ndërtimeve që shërbejnë për kultivimin e organizmave ujorë, të tilla si vaskat, kanalet furnizuese dhe shkarkuese, inkubatorët, laboratorët, magazinat frigoriferike, si dhe çdo ndërtim tjetër që shërben për akuakulturë dhe që janë në pronësi ose në përgjegjësi menaxhimi të një enti shtetëror.”

Neni 2

Në nenin 5, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

¹ Ky ligj është përafuar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr. 1379/2013, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 11 dhjetor 2013, “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon rregulloret e Këshillit (KE) nr. 1184/2006 dhe (KE) nr. 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 104/2000”, të ndryshuar”. Numri CELEX 32013R1379, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 354, datë 28.12.2013, faqe 1–21.

“1. ZPA-ja përfshin zona të veçanta, të caktuara, përfshirë edhe instalimet në pronësi shtetërore, me qëllim aktivitetin e akuakulturës, së bashku me infrastrukturën në shërbim të saj.”.

Neni 3

Pas nenit 44 shtohen nenet 44/1 dhe 44/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 44/1
Organizatave e prodhuesve

1. Organizatat e prodhuesve të sektorit të akuakulturës krijohen me nismën e prodhuesve të produkteve të akuakulturës dhe të njohura, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar.

2. Një organizatë e prodhuesve që përfaqëson aktivitetet e akuakulturës dhe të peshkimit, mund të krijohet si organizatë e përbashkët e prodhuesve në sektorët e peshkimit dhe të akuakulturës.

3. Kur është e nevojshme, në momentin e krijimit të organizatës së prodhuesve, duhet të mbahet parasysh gjendja specifike e prodhuesve të vegjël.

Neni 44/2

Objektivat e organizatave të prodhuesve

1. Organizatat e prodhuesve në sektorin e akuakulturës ndjekin objektivat si më poshtë:

a) nxisin realizimin e aktiviteteve të qëndrueshme të akuakulturës të anëtarëve të tyre, me anë të mundësive të zhvillimit, të ofruara në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare të Peshkimit dhe legjislacionit në fushën e mjedisit, duke respektuar politikën sociale;

b) sigurojnë që aktivitetet e anëtarëve të tyre të jenë në përputhje me planet strategjike kombëtare;

c) synojnë të sigurojnë që ushqimet për akuakulturën me origjinë nga peshkimi, të vijnë nga peshkimi i menaxhuar në mënyrë të qëndrueshme.

2. Përveç objektivave të përcaktuar në pikën 1, të këtij neni, organizatat e prodhuesve ndjekin dy ose më shumë objektiva si më poshtë:

a) përmirësojnë kushtet për vendosjen në treg



të produkteve të akuakulturës së anëtarëve të tyre;

b) përmirësojnë performancën ekonomike;

c) stabilizojnë tregjet;

ç) kontribuojnë në furnizimin me ushqim dhe promovojnë standarde të larta të cilësisë dhe sigurisë ushqimore dhe, në të njëjtën kohë, promovojnë punësimin në zonat bregdetare e rurale;

d) zvogëlojnë ndikimin mjedisor të akuakulturës.

3. Organizatat e prodhuesve mund të ndjekin objektiva të tjerë plotësues.”

Neni 4

Dispozitë kalimtare

1. Pezullimi i përcaktuar në pikën 3, të nenit 50, të ligjit, nuk zbatohet për instalimet, pronë ekzistuese shtetërore të akuakulturës.

2. Kontratat e lidhura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, të cilave u mbaron afati përpara miratimit të ZPA-së, konsiderohen të vlefshme deri në miratimin e ZPA-së, nëse ushtruesi i veprimtarisë së akuakulturës bën kërkesë për zgjatje. Kërkesa për zgjatjen e afatit të kontratës refuzohet në rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 2, të nenit 25, të ligjit.

3. Kontratat e parashikuara në pikën 2, të këtij neni, mbeten të vlefshme deri në përfundimin e ciklit të prodhimit, por jo më shumë se 18 muaj nga miratimi i ZPA-së.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 3.4.2019.

Shpallur me dekretin nr. 11176, datë 19.4.2019 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta

VENDIM

Nr. 244, datë 24.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT DREJTUES TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS DHE PËR MASËN E SHPËRBLIMIT PËR VEPRIMTARINË E ANËTARËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITË E PËRGJITHSHME

1. Objekt i këtij projektvendimi është përcaktimi i rregullave të funksionimit të këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përcaktimi i rasteve të mbarimit të mandatit dhe të shkarkimit të anëtarëve, si dhe të masës së shpërblimit financiar të anëtarëve dhe të sekretariatit teknik.

II. ANËTARËT DHE KRYETARI

2. Anëtarët e këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në vijim (ASHK), gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, udhëhiqen nga parimet e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative dhe në nenin 5, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

3. Mandati i anëtarit të këshillit drejtues të ASHK-së mbaron:

a) kur jep dorëheqjen;

b) kur përfundon mandati 4-vjeçar i qëndrimit në detyrë;

c) kur mbush moshën e pensionit;

ç) në rast vdekjeje të tij.

4. Rastet e shkarkimit të anëtarëve të këshillit drejtues janë, si më poshtë vijon:

a) kur ndërpret marrëdhëniet e punës me institucionin që përfaqëson;

b) kur zëvendësohet, sipas diskrecionit të institucionit propozues dhe të Këshillit të Ministrave;

c) kur dënohet me vendim penal të formës së prerë;

ç) kur bëhet i paaftë mendërisht ose fizikisht për të ushtruar detyrën;



d) kur nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit drejtues, më shumë se 3 herë radhazi.

dh) kur me veprimet e tij dëmton veprimtarinë e këshillit drejtues.

5. Në rast vakance në pozicionin e anëtarit të këshillit drejtues, ASHK-ja, brenda 5 (pesë) ditëve nga konstatimi i vakancës, njofton institucionin përkatës për propozimin e anëtarit të ri. Institucioni propozues duhet t'i përcjellë Këshillit të Ministrave anëtarin e ri, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i ASHK-së.

6. Zgjedhja e kryetarit të këshillit drejtues bëhet sipas përcaktimeve të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën". Kohëzgjatja në detyrë e kryetarit është 2 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

III. MBLEDHJET DHE VENDIMMARRJA

7. Këshilli drejtues mbledhet, si rregull, çdo muaj, si dhe sa herë që kërkohet nga drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së, sipas nevojave të Agjencisë.

8. Mbledhja e këshillit drejtues është e vlefshme nëse në të janë të pranishëm, të paktën, katër anëtarë.

9. Mbledhja e këshillit drejtues të ASHK-së drejtohet nga kryetari dhe, në rast mungese të tij, nga anëtari më i vjetër në moshë.

10. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Në rastet kur nga votimi nuk arrihet shumica, vendimarrja përcaktohet nga vota e kryetarit.

11. Këshilli drejtues, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, asistohet nga sekretariati teknik, i përbërë nga 3 (tre) punonjës të ASHK-së, të caktuar nga drejtori i përgjithshëm.

IV. MASA E SHPËRBLIMIT

12. Kryetari i këshillit drejtues merr shpërblim mujor në masën 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

13. Anëtarët e këshillit drejtues marrin shpërblim mujor në masën 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

14. Anëtarët e sekretariatit teknik të këshillit drejtues marrin shpërblim mujor në masën 5 000 (pesë mijë) lekë.

15. Shpenzimet për shpërblimin e kryetarit, të anëtarëve dhe të sekretariatit teknik të këshillit drejtues, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje, përballohen nga buxheti i ASHK-së.

V. DISPOZITË E FUNDIT

16. Për çështjet që nuk janë të rregulluara posaçërisht në këtë vendim, funksionimi i këshillit drejtues i nënshtrohet rregullave të parashikuara në legjislacionin për organet kolegjiale të administratës shtetërore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 245, datë 24.4.2019

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE E TË SHITESAVE MBI PAGË TË NËPUNËSVE DHE PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË NË AGJENCINË SHTETËRORE TË KADASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", dhe të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 111/2018, "Për kadastrën", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave e të shtesave mbi pagë për nëpunësit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

2. Elementet e pagës për secilën kategori, të përcaktuara në lidhjet nr. 1 e nr. 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi, si dhe vlerat për secilin element, janë të njëjta me ato të miratuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në institucionet e administratës shtetërore.

3. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat "Specialist" deri në "Titullar institucioni", në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, janë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.



4. Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni”, në drejtoritë vendore dhe zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, janë sipas lidhjes nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Pagat dhe shtesat mbi pagë të punonjësve administrativë në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës janë sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve të administratës shtetërore.

6. Vendimi nr.217, datë 20.3.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e nivelit të pagave të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme”, shfuqizohet.

7. Emërtesat “Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale”, përmendur në shkronjën “a”, të pikës 1/3, dhe “Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike”, përmendur në shkronjën “b”, të pikës 1/3, dhe në pikat 9/2 e 12/3 dhe lidhjet 6/2 e 9/3, të vendimit nr.187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve

të kabinetëve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar, shfuqizohen.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.111/2018, “Për kadastrën”, si dhe nga buxheti i miratuar për vitin 2019, në ligjin e buxhetit për Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencinë e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike. Efektet financiare fillojnë nga momenti i emërimit, transferimit të nëpunësve/punonjësve në pozicionet e reja të punës, por jo më vonë se 6 muaj, nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 1

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtorinë e Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PÛRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
Titullar i institucionit.	I-b	1	15.000
Zëvendëstitullar i institucionit.	II-a	1	20.000
Drejtor Njësie.	II-b	1	15.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë e përmbajtjes.	II-b	1	20.000
Drejtor drejtorie në drejtoritë që lidhen me procesin e informatizimit.	II-b	1	12.000
Përgjegjës sektori në sektorët e	III-a	1	15.000



përmbytjes.			
Përgjegjës sektori në sektorët që lidhen me procesin e informatizimit.	III-a	1	20.000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës. Koordinator.	III-a/1	1	12.000
Specialist në drejtoritë dhe sektorët e përmbytjes.	IV-a	1 ose 2 ose 3	15.000
Specialist në pozicionet që lidhen me procesin e informatizimit.	IV-a	1 ose 2 ose 3	20.000
Specialist në drejtoritë dhe sektorët mbështetës.	IV-a	1 ose 2 ose 3	12.000
	IV-b		

Lidhja nr. 2

Kategoritë e pagave dhe shtesat për kushte pune të pozicioneve të punës së nëpunësve për emërtesat “Specialist” deri në “Titullar institucioni” në Drejtoritë Vendore dhe Zyrat Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
Titullar i drejtorive vendore të kategorisë së parë.	III-a	1	20.000
Titullar i drejtorive vendore të kategorisë së dytë.	III-a/1	1	18.000
Zëvendëstitullar i drejtorive vendore të kategorisë së parë.	III-a/1	1	16.500
Zëvendëstitullar i drejtorive vendore të kategorisë së dytë.	III-b	1	16.500
Drejtor në drejtoritë e përmbytjes në drejtoritë vendore të kategorisë së parë.	III-a/1	1	15.000
Drejtor në drejtoritë e mbështetjes në drejtoritë vendore të kategorisë së parë.	III-a/1	1	12.000
Drejtor në drejtoritë e përmbytjes në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë.	III-b	1	15.000
Drejtor në drejtoritë e mbështetjes në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë.	III-b	1	12.000
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbytjes në drejtoritë vendore të kategorisë së parë.	III-b	1	15.000
Përgjegjës sektori në sektorët e përmbytjes në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë.	IV-a	1	15.000
Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në drejtoritë vendore të kategorisë së parë.	III-b	1	12.000



Përgjegjës sektori në sektorët mbështetës në drejtoritë vendore të kategorisë së dytë.	IV-a	1	12.000
Titullar i Zyrës Vendore	IV-a	1	15.000
Specialist në drejtoritë dhe sektorët e përmbytjes në drejtoritë vendore. Specialist në zyrat vendore.	IV-b	1 ose 2 ose 3	15.000
Specialist në drejtoritë dhe sektorët mbështetës në drejtoritë vendore.	IV-b	1 ose 2 ose 3	12.000

Kategorizimi i drejtorive vendore është si vijon:

- Kategoria e parë: Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Durrës, Elbasan, Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, Vlorë, Fier, Kamëz – Vorë, Shkodër, Korçë, Lezhë, Berat, Kavajë, Gjirokastrë, Krujë, Lushnje, Pogradec, Sarandë, Dibër, Kukës dhe Zonat e Stimuluara.
- Kategoria e dytë: Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kuçovë dhe Tepelenë.

UDHËZIM

Nr. 3/1, datë 15.4.2019

PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 6 dhe 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, të pikës 5, të VKM nr. 128, datë 13.3.2019, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit

për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2019”, të ndryshuar, të udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 19, datë 3. 11. 2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të masës së kompensimit të prodhimeve bujqësore, për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”,

UDHËZOJMË:

I. NDARJA E FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Fondi prej 579 000 000 lekë, nga programi për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2019 dhe 125 000 000 lekë nga projekti “Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të ullirit”, të përdoret sipas masave, si më poshtë vijon:

Nr. i masës	Emërtimi i masës
1	Për tufën bazë të matrikulluar, për fermat me jo më pak se 100 krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1000 (njëmijë) lekë/krerë.
2	Dorëzim qumështi lëndë e parë, në vlerën 10 lekë për litër në pikat e përpunimit, për fermat që mbarështojnë lopë dhe/ose të imëta, kundrejt faturës tatimore të shitjes, por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë për subjekt.
3	Mbarështrim i bletarisë me 1 000 (njëmijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 zgjoje, por masa e financimit të jetë jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt.



4	Mbështetje ndaj anijeve të peshkimit me flamur shqiptar, në vlerën 20 (njëzet) lekë/kg për açuge dhe/ose sardele të peshkuara. Pagesa të kryhet kundrejt sasive të tregtuara në stabilimentet shqiptare vetëm për qëllime përpunimi të këtyre produkteve, të vërtetuara me fatura tatimore dhe certifikatë zënieje. Në rastin kur anijet janë në pronësi ose të marra me qira nga stabilimentet e përpunimit të peshkut, pagesa të kryhet kundrejt sasive të verifikuara me certifikatë zënieje dhe/ose: - faturave të shitjes së produkteve të përpunuara për në tregun vendas; - të deklaratës doganore për eksportin e prodhimeve të përpunuara.
5	Mbjellje e ullinjve në vlerën 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale. Kur kultivari është autokton masa e financimit shtohet me 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë/ha. Sipërfaqja e mbjellë me ullinj për fermerët individual të jetë jo më pak se 0.2 ha, për grup-fermerësh jo më pak se 1 ha, në një bllok të vetëm, për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) jo më pak se 3 ha. Madhësia e ngastrës të jetë, jo më pak se 0.2 ha, kur nuk është në bllok. Masa e financimit për sipërfaqe të mbjellë, të jetë: - deri në 0.5 ha, me 100% të vlerës për ha; - mbi 0.5-5 ha (4.5 ha e dytë) të rritet me 25% të vlerës për ha; - mbi 5.0-10 ha (5 ha e tretë), të rritet me 50% të vlerës për ha; Masa e financimit për sipërfaqe të mbjellë, për aplikuesit me status SHBB: - 3-5 ha, të rritet me 40% të vlerës për ha; - mbi 5.0-10 ha (5 ha e dytë), të rritet me 65% të vlerës për ha.
5.1	Pagesa për plotësimin e numrit të bimëve në ullishtat e vjetra/degraduara në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/ha.
6	Përmirësimi i teknikave të ujitjes nëpërmjet instalimit të ujitjes me pika në ullinj, jo më shumë se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha.
7	Blerje e makinerive dhe pajisjeve për vjeljen e ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.
8	Blerje e makinerive dhe pajisjeve për prodhimin e vajit të ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt.
9	Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 10 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga Programi IPARD II.
10	Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga Programi IPARD II.
	Mbështetje për Fermën Didaktike Eksperimentale (FDE), të Universitetit Bujqësor të Tiranës (UBT) në vlerën deri në 125 milionë lekë, nëpërmjet transferimit të fondit nga llogaria ekonomike 606 në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferata të brendshme” për financimin e projekteve, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR) ekzekuton transferimin e fondit përkatës tek UBT-ja, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.



Fondi i planifikuar sipas masave mbështetëse:

Masat 1-4 dhe 9-10	368 500 000 lekë
Masat 5-5.1	60 000 000 lekë
Masa 6	15 000 000 lekë.
Masa 7	10 000 000 lekë.
Masa 8	40 000 000 lekë

II. KUPITIMI I SHKURTIMEVE

MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (Agjencia e Pagesave)
AREB	Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor
ARSHVMB	Agjencitë Rajonale të Shërbimit Veterinar dhe të Mbrojtjes së Bimëve;
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
DPAP	Drejtoria e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve, AZHBR
DK	Drejtoria e Kontrollit, AZHBR
ESHFF	Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve
DAP	Drejtoria e Autorizimit të Pagesave në AZHBR
DEP	Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave në AZHBR
DAMT	Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në qark
SPAP	Spektori i Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve në AZHBR
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
NIPT	Numri i Identifikimit i Personit të Tatueshëm
NUIS	Numri Unik i Identifikimit të Subjektit
SHBB	Shoqëri e Bashkëpunimit Bujqësor
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

III. KRITERE TË PËRGJITHSHME TË PËRFTITIMIT

1. Aplikanti duhet të jetë shtetas shqiptar ose kompani me bashkëpronësi, njëri nga të cilët të jetë shqiptar.

2. Përfitues sipas masave mbështetëse mund të jenë fermerë individualë, grup-fermerësh, subjekte me status fizik, juridik, SHBB.

3. Fermerët individualë të jenë të pajisur me NIPT-in e fermerit me status aktiv.

4. SHBB-të dhe personat fizikë dhe juridikë të jenë të pajisur me NIPT/NUIS me status aktiv.

5. Mbështetja financiare për masat mbështetëse të jetë sipas hartës së shpërndarjes së masave mbështetëse, në aneksin 1 dhe përcaktimeve në këtë udhëzim.

6. Aplikantët (subjekti, ortaku, përfaqësuesi ligjor, anëtarët e SHBB-së), nëse rezultojnë debitorë ndaj AZHBR-së, MBZHR-së dhe Tatimeve, kanë afat deri më datë 7.6.2019 që të shlyejnë detyrimet dhe të sjellin pranë pikës së aplikimit brenda kësaj date vërtetimin nga

institucioni përkatës që nuk kanë më detyrime.

7. Aplikanti në rast se rezulton që nuk e ka realizuar “shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore” në momentin e aplikimit, duhet të paraqesë pranë pikës së aplikimit vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve jo më vonë se data 7.6.2019.

8. Për investimet, ofertat/faturat në valutë të huaj do të zbatohet kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e hapjes së aplikimit.

9. Për masat mbështetëse direkte që kërkohen faturat/aktet e zhdoganimit, duhet të jenë të lëshuara gjatë vitit 2019, në përmbushje me kërkesat e masës përkatëse.

10. Për masat mbështetëse të investimeve, punimet dhe faturat/aktet e zhdoganimit duhet të jenë pas datës së lidhjes së kontratës.

11. Të gjitha linjat, makineritë dhe pajisjet të jenë të reja.

12. Për masat mbështetëse të investimeve në rastin e ndërtimeve/rikonstruksioneve aplikuesi duhet të ketë aplikimin për leje ndërtimi në



aplikim dhe duhet të ketë lejen përkatëse të ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi, para lidhjes së kontratës, por jo më vonë se data 7.6.2019. Projekti i miratuar me leje ndërtimi duhet të jetë i njëjtë me projektin e paraqitur në AZHBR për aplikim.

13. Për investimet ku masa e financimit është me vlerë mbi 10 milionë lekë, investimi përkatës të jetë i siguruar të paktën deri në vlerën e financimit nga AZHBR-ja dhe ky kusht parashikohet në kontratën e lidhur me subjektin përfitues.

14. Financimi i shumës së përfituar bëhet në bankat e nivelit të dytë.

15. I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar dhe i vërtetuar nga noter i publik.

16. Aplikanti për masat 3, 4, 9 dhe 10 mund të aplikojë dhe përfitojë vetëm në njërin prej tyre, ndërsa për grup-masën 1–2 ose grup-masën 5–8, mund të aplikojë dhe përfitojë në më shumë se një masë mbështetëse.

Kriteret e përcaktuara në pikat 1–4, të këtij kreu, vërtetohen nga sistemi *e-Albania* ose nga burime të tjera zyrtare.

IV. APLIKIMI

Informacioni për mënyrën e aplikimit, kriteret e përfitimit dhe procedimit deri në përfitimin e mbështetjes financiare gjendet pranë agropikave, pranë agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor dhe zyrave qendrore të AZHBR-së, si dhe në faqen e saj të internetit: www.azhbr.gov.al

Aplikimet për masat direkte do të bëhen nga data 22.4.2019 deri më 10.5.2019, ndërsa për masat e investimeve nga data 22.4.2019 deri më 17.5.2019.

1. Aplikimi *on-line*

a) aplikimet për masat mbështetëse direkte me nr. 1–6 do të bëhet *online*;

b) aplikimi *on-line* bëhet mbi bazën e parimit “zero dokumente” në momentin e aplikimit;

c) aplikimi *on-line* do të bëhet pranë agropikave, zyrave të AREB-së ose nga aplikanti në portalin *e-Albania*. Lista e zyrave të aplikimit jepet në aneksin 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi; të dhënat e gjeneruara nga portali *e-Albania* dhe të konfirmuara në formularin on line të gjeneruar nga portali, nuk kanë nevojë për dokumente shtesë.

d) Aplikimi *on-line* do të bëhet me asistencë nga inspektorët/specialistët e AGROPIKA-ve, specialistët e ekstensionit, ose nga vetë aplikanti nëpërmjet portalit *e-Albania*.

e) Me urdhër të veçantë të drejtorit të përgjithshëm të AZHBR-së, emërohen pranuesit e aplikimeve si dhe numri i tyre për çdo zyrë aplikimi;

f) Përfitues për masat mbështetëse të mësipërme mund të jenë fermerë individualë, grup-fermerësh, subjekte me status fizik, juridik, SHBB;

g) Gjatë periudhës së aplikimit sportelet e pranimit të aplikimeve do të qëndrojnë të hapura nga ora 8:00 deri në 16:30. Nëse në orën 16:30 ka aplikantë në zyrat e aplikimit, sportelet do të qëndrojnë të hapura deri në përfundim të të gjithë aplikantëve, që kanë qenë prezent në orën 16:30. Në ditët e premtë orari do të jete 8:00–14:30;

h) Për qëllime identifikimi, aplikanti, duhet të paraqitet në sportelin e aplikimit me kartë identiteti/ pasaportë biometrike. Në rastin kur aplikanti është me status fermer, krahas tyre duhet të ketë NIPT-in aktiv të fermerit;

i) Aplikanti duhet të jetë i regjistruar ose të bëjë regjistrimin në portalin *e-Albania* (si individ dhe subjekt) në mënyrë që të vijojë me aplikimin online përmes portalit *e-Albania*;

j) Të gjithë aplikantët me status fermer ose person fizik dhe juridik, që kryejnë aktivitet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, para aplikimit duhet të plotësojnë regjistrin e fermës sipas aneksit 3;

k) Me plotësimin e regjistrit të fermës, fillon aplikimi për masën përkatëse;

l) Për masat ku kërkohen dokumentat e pronësisë/qiramarrjes, dokumentat përkatëse mund të paraqiten që në momentin e aplikimit. Në rast mangësish, afati maksimal i dorëzimit të tyre do të jetë data 7.6.2019. Plotësimi i dokumentave përtej kësaj date do të rezultojë në skualifikim të aplikimit.

m) Në zyrat e aplikimit mund të paraqitet personalisht aplikanti ose një përfaqësues i tij i pajisur me prokurë përfaqësimi para noterit ose me dokument zyrtar me vulë të njomë të subjektit.

n) Në fund të procesit të aplikimit gjenerohet varianti i printuar i formularit të aplikimit, i cili



firmoset nga aplikanti dhe pranuesi i aplikimeve.

o) Procedura e aplikimit nga portali *e-Albania*, përfundon me dërgimin me sukses të formatit elektronik të formularit të aplikimit.

Renditja e aplikimeve bëhet automatikisht nga sistemi në rang kombëtar dhe për çdo masë mbështetëse.

2. Aplikimi me dosje në AZHBR

a) Aplikimet për masat mbështetëse të investimeve me nr. 7-10 do të bëhen me dosje në zyrat qendrore të AZHBR-së;

b) Për qëllime identifikimi, aplikanti sipas statusit përkatës (fermer/ person fizik/ juridik, SHBB) duhet të paraqitet në zyrat qendrore të AZHBR-së me kartë identiteti/pasaportë biometrike.

c) Nëse aplikantët kanë statusin fermer ose person fizik dhe juridik, që kryen aktivitet për prodhimin bujqësor dhe blegtoral, ata duhet të kenë plotësuar formularin e regjistrimit të fermës në zyrat qendrore të AZHBR-së.

V. DOKUMENTACIONI QË GJENEROHET NGA REGJISTRAT ZYRTARË DHE PLATFORMA E-ALBANIA

1. Formulari i aplikimit për masën mbështetëse përkatëse;

2. Të dhënat e kartës së identitetit të aplikantit;

3. Dokumenti që vërteton statusin e aplikantit (fermer, person fizik/juridik, SHBB);

4. Konfirmimi që aplikanti (ortakët, përfaqësuesi ligjor, anëtarët e SHBB) nuk janë debitor ndaj AZHBR-së, MBZHR-së apo Tatimeve;

5. Dokumenti për “shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore”;

6. Leje apo licenca për masat përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi;

7. Regjistri elektronik i blegtorisë (RUDA) dhe bletarisë.

Aplikantët, për të cilët ndonjë dokument nuk arrihet të gjenerohet nga regjistrat zyrtarë apo nuk plotësojnë kriteret e përfitueshmërisë, informohen nëpërmjet listës së aplikimeve të kualifikuara.

Afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit, në agropikën më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së, ose me postë në zyrat qendrore të AZHBR-së, është data 7.6.2019.

Mosplotësimi i kriterëve të përfitueshmërisë përtej afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi.

VI. KRITERET SPECIFIKE DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR MASAT DIREKTE 1–6

MASA 1. Për tufën bazë të matrikulluar, për fermat me jo më pak se 100 krerë dele dhe/ose dhi, në vlerën 1000 (njëmijë) lekë/krerë.

i. Kriteret specifike për masën

Përfituesit e mundshëm: fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik.

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;

b) Aplikanti duhet të ketë në tufën bazë jo më pak se 100 krerë dele dhe/ose dhi të matrikulluara;

c) Kafshët e tufës bazë duhet të jenë të regjistruara në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve- RUDA;

d) Aplikanti të deklarojë vendndodhjen e tufës në momentin e aplikimit. Në rast ndryshimi të vendndodhjes aplikanti informon grupin e kontrollit për vendndodhjen e re;

e) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së, AZHBR-së dhe Tatimeve. Në rast se rezulton debitor, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019;

f) Aplikanti i shpallur në listën e të kualifikuarve, në rast se rezulton se sigurimet shoqërore nuk janë të shlyera, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve

Do të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e të kualifikuarve brenda datës 7.6.2019.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit;

Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

MASA 2. Dorëzim qumështi lëndë e parë, në vlerën 10 lekë për litër në pikat e përpunimit, për fermat që mbarështojnë lopë dhe/ose të imëta, kundrejt faturës tatimore të shitjes, por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë për subjekt.

**i. Kriteret specifike për masën**

Përfituesit e mundshëm: fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik.

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv.

b) Kafshët e tufës bazë duhet të jenë të regjistruara në sistemin e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve- RUDA;

c) Mbështetja financiare kryhet për faturat tatimore të lëshuara dhe të dorëzuara në AZHBR, që nga data 1 janar 2019, por jo më vonë se data 30.11.2019;

d) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së, AZHBR-së dhe Tatimeve. Në rast se rezulton debitor, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019;

e) Aplikanti i shpallur në listën e të kualifikuarve, në rast se rezulton se sigurimet shoqërore nuk janë të shlyera, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve.

Do të dorëzojë dokumentacionin e specifikuar në listën e të kualifikuarve brenda datës 7.6.2019.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit;

Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

iv. Dokumenti i dorëzuar pas verifikimit në terren

a) Faturat tatimore për sasinë e qumështit të shitur;

b) Faturat tatimore të dorëzimit të qumështit të jenë sipas statusit të aplikantit:

- Kur aplikuesi është subjekt tatimor (fizik ose juridik) dorëzohen fatura me TVSH ose fatura të thjeshta tatimore;

- Kur aplikuesi është fermer individual, dorëzohen fatura tatimore të lëshuar nga blerësi (autofaturë);

c) Faturat e Thjeshta Tatimore të jenë të shoqëruara me kupon tatimor ose transfertë bankare;

d) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të

bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

MASA 3. Mbarështim i bletarisë me 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 zgjoje, por masa e financimit të jetë jo më shumë se 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë për subjekt

i. Kriteret specifike për masën

Përfituesit e mundshëm: fermerë individualë, SHBB, person fizik ose juridik.

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv.

b) Aplikanti në momentin e verifikimit të ketë jo më shumë se 1 vendndodhje për 50 koshere të bletëve, jo më shumë se 2 vendndodhje për 100 koshere dhe jo më shumë se 3 vendndodhje për 150 koshere;

c) Kosheret e bletëve të jenë të matrikulluara dhe të regjistruara në regjistrin elektronik të ARSHVMB-së përkatëse;

d) Aplikanti të deklarojë vendndodhjen e parqeve në momentin e aplikimit. Në rast ndryshimi, aplikanti të deklarojë vendndodhjen e parqeve në momentin e verifikimit në terren;

e) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së, AZHBR-së dhe Tatimeve. Në rast se rezulton debitor, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019;

f) Aplikanti i shpallur në listën e të kualifikuarve, në rast se rezulton se sigurimet shoqërore nuk janë të shlyera, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019.

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikanti, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve.

Do të dorëzojë dokumentacionin e munguar, të specifikuar në listën e të kualifikuarve brenda datës 7.6.2019.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit.

Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

MASA 4. Mbështetje ndaj anijeve të peshkimit me flamur shqiptar, në vlerën 20 (njëzet) lekë/kg për açuge dhe/ose sardele të peshkuara. Pagesa të kryhet kundrejt sasive të tregtuara në stabilimentet shqiptare



vetëm për qëllime përpunimi të këtyre produkteve, të vërtetuara me fatura tatimore dhe certifikatë zënieje. Në rastin kur anijet janë në pronësi ose të marra me qira nga stabilimentet e përpunimit të peshkut, pagesa të kryhet kundrejt sasive të verifikuara me certifikatë zënieje dhe/ose:

- faturave të shitjes së produkteve të përpunuara për në tregun vendas;
- të deklaratës doganore për eksportin e prodhimeve të përpunuara.

i. Kriteret specifike për masën

Përfituesit e mundshëm: Person fizik ose juridik në qarqet Lezhë, Durrës, Elbasan dhe Vlorë.

- a) Aplikanti duhet të ketë NIPT/NUIS aktiv.
- b) Aplikanti të ketë në pronësi ose me qira anije të peshkimit për açuge dhe sardele;
- c) Anija e peshkimit të jetë e regjistruar në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit;
- d) Të ketë leje të vlefshme peshkimi për pellagjikët e vegjël (me rrethim ose pellagjikë);
- e) Të ketë bërë pagesën e taksës vjetore të lejes;
- f) Të ketë certifikatë zënie dhe *logbook*-un përkatës të plotësuar;
- g) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së, AZHBR-së dhe Tatimeve. Në rast se rezulton debitor, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019.
- h) Aplikanti i shpallur në listën e të kualifikuarve, në rast se rezulton se sigurimet shoqërore nuk janë të shlyera, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019;

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve

- a) Dokumenti i pronësisë ose i marrjes me qira të anijes së peshkimit për açuge dhe sardele;
- b) Vërtetimi që anija është regjistruar në Regjistrin e Anijeve të Peshkimit, në emër të subjektit;
- c) Leje peshkimi të vlefshme për vitin e aplikimit;
- d) Dokumenti që vërteton pagesën e taksës vjetore të lejes;
- e) Fotokopje ose vërtetim të dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit;

Ky dokument mund të dorëzohet që në momentin e aplikimit dhe bëhet pjesë e dosjes së aplikantit, skanohet dhe ngarkohet në sistem.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

iii.1. Për anijet e peshkimit që shesin sardele dhe/ose açuge në stabilimentin e përpunimi të peshkut:

- a) Faturë shitje me TVSH në stabilimentin e përpunimit të peshkut;
- b) Certifikatë zënie dhe *logbook*-un e plotësuar për çdo faturë shitje në stabilimentin e përpunimi të peshkut.

iii.2. Për anijet që janë në pronësi ose të marra me qira nga stabilimentet e përpunimit të peshkut:

- a) Certifikatë zënie dhe *logbook*-un e plotësuar;
- b) Fatura e shitjes me TVSH e produkteve të përpunuara për në tregun vendas ose deklarata doganore për eksportin e prodhimeve të përpunuara;
- c) Karta teknologjike e produktit të përpunuar të miratuar nga AKU-ja.

MASAT 5 dhe 5/1

MASA 5. Mbjellje e ullinjve në vlerën 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe në vlerën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha, për format tradicionale. Kur kultivari është autokton masa e financimit shtohet me 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë/ha.

Sipërfaqja e mbjellë me ullinj për fermerët individual të jetë jo më pak se 0.2 ha, për grup-fermerësh jo më pak se 1 ha, në një bllok të vetëm, për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor (SHBB) jo më pak se 3 ha. Madhësia e ngastrës të jetë, jo më pak se 0.2 ha, kur nuk është në bllok.

Masa e financimit për sipërfaqe të mbjellë, të jetë:

- deri në 0.5 ha, me 100% të vlerës për ha;
- mbi 0.5-5 ha (4.5 ha e dytë) të rritet me 25% të vlerës për ha;
- mbi 5.0-10 ha (5 ha e tretë), të rritet me 50% të vlerës për ha;

Masa e financimit për sipërfaqe të mbjellë, për aplikuesit me status SHBB:

- 3-5 ha, të rritet me 40% të vlerës për ha;
- mbi 5.0 -10 ha (5 ha e dytë), të rritet me 65% të vlerës për ha.



MASA 5/1: Pagesa për plotësimin e numrit të bimëve në ullishtat e vjetra/degraduara në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë/ha.

i) Kriteret specifike për masat

Përfituesit e mundshëm: fermerë, grup-fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik.

a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;

b) Për masën 5, sipërfaqja e mbjellë me ullinj për fermerët individual të jetë jo më pak se 0.2 ha, për grup-fermerësh jo më pak se 1 ha, në një bllok të vetëm, për Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) jo më pak se 3 ha. Sipërfaqja mbi 10 ha për mbjelljet e reja nuk mbështetet me bonus. Madhësia e ngastrës të jetë, jo më pak se 0.2 ha, kur nuk është në bllok;

c) Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor të jetë i certifikuar dhe i regjistruar në Katalogun Kombëtar të Specieve dhe Varieteteve, sipas aneksit 4.

d) Toka bujqësore të jetë në pronësi të aplikantit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet përfshirë vitin para realizimit të mbjelljeve;

e) Të realizojnë mbjelljet brenda datës 30 nëntor 2019;

- Sistemi i aplikimit rendit në fillim të listës aplikantët që vetëdeklarojnë realizimin e mbjelljeve brenda 6 muorit të parë 2019.

- Gjatë verifikimit në terren në qoftë se vetëdeklarimi për mbjelljet në 6 muorin e parë është realizuar, aplikimi skualifikohet.

f) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së, AZHBR-së dhe Tatimeve. Në rast se rezulton debitor, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019.

g) Aplikanti i shpallur në listën e të kualifikuarve, në rast se rezulton se sigurimet shoqërore nuk janë të shlyera, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019;

ii. Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve

a) Marrëveshje e dakordësisë së anëtarëve të grup-fermerëve, SHBB-së apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon;

b) Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo marrjes me qira;

Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtme:

- Certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;

- Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, të vërtetuar nga DAMT-ja ose njësia administrative ku ndodhet ngastra.

Në të dyja rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësi i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakordësia para noterit e bashkëpronarëve të familjes bujqësore.

Kur aplikuesi merr tokë me qira:

-Kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve në prani të noterit. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet duke përfshirë edhe vitin para aplikimit.

c) Projektin për mbjelljen e ullirit sipas formularëve në anekset 5 dhe 5.1;

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

a) Fotokopje ose vërtetim i dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktive të aplikantit;

b) *Për fidanët e prodhuar në vend:*

- Faturë tatimore e blerjes së fidanëve, lëshuar nga subjekti tregtues, ku specifikohet kultivari dhe sasia e fidanëve të blerë;

- Një fotokopje të certifikatës zyrtare për materialin mbjellës (lëshuar nga ESHFF-ja), nga subjekti i certifikuar me nënshkrim e vulë të njomë të subjektit tregtues.

c) *Për fidanët e importuar:*

- Faturën tatimore të blerjes lëshuar nga subjekti tregtues ose aktin e zhdoganimit, ku specifikohet specia, kultivari dhe sasia e materialit mbjellës të blerë;

- Fotokopje të certifikatës së origjinës/certifikatës fitosanitare/certifikatës nga AKU-ja, të vërtetuar me origjinalen me nënshkrimin dhe vulën e njomë të subjektit tregtues.

MASA 6. Përmirësimi i teknikave të ujitjes nëpërmjet instalimit të ujitjes me pika në ullinj, jo më shumë se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha.

i. Kriteret specifike për masën:

Përfituesit e mundshëm: Fermerë, grup-fermerësh, SHBB, person fizik ose juridik.



- a) Aplikanti duhet të ketë NIPT aktiv;
- b) Sipërfaqja e ullishtës të jetë jo më pak se 0.2 ha;
- c) Tubacioni kryesor i furnizimit me ujë të sistemit shpërndarës të jetë i vendosur nëntokë;
- d) Sistemi ujitës të jetë funksional në momentin e kontrollit në terren;
- e) Masa e financimit të jetë në 50% të vlerës të faturave tatimore;
- f) Të gjithë elementet e sistemit të ujitjes me pika të jenë të reja dhe të shprehura në faturë;
- g) Toka të jetë në pronësi të aplikantit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet përfshirë vitin paraardhës;
- h) Të realizojnë instalimin e impiantit të ujitjes me pika brenda datës 30 shtator 2019;
- i) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj MBZHR-së, AZHBR-së dhe Tatimeve. Në rast se rezulton debitor, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019;
- j) Aplikanti i shpallur në listën e të kualifikuarve, në rast se rezulton se sigurimet shoqërore nuk janë të shlyera, afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentit që vërteton shlyerjen e detyrimeve do të jetë data 7.6.2019.
- k) Pajisjet duhet të jenë të reja dhe me origjinë nga Italia.

ii) Dokumentacioni që dorëzohet nga aplikuesi, pas përfshirjes në listën e të kualifikuarve

- a) Marrëveshje e dakordësisë së anëtarëve të grup-fermerëve, SHBB apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon;
 - b) Dokumentacionin e pronësisë së tokës apo marrjes me qira;
- Pronësia mbi tokën bujqësore, vërtetohet me një nga dokumentet e mëposhtme:
- Certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme;
 - Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, të vërtetuar nga DAMT-ja ose njësi administrative ku ndodhet ngastra.

Në të dyja rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësia i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakorësia para noterit e bashkëpronarëve të familjes bujqësore.

Kur aplikuesi merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve në prani të noterit. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë edhe vitin para aplikimit.

- c) Projektin për instalimin e sistemit ujitës të ullirit sipas formularit në aneksin 6.

iii. Dokumentacioni i dorëzuar në momentin e verifikimit

- a) Fatura/faturat tatimore të blerjeve përkatëse, të detajuara me vlerën e elementeve përbërëse, shoqëruar me specifikimet teknike;
- b) Akt zhdoganimit për rastet kur materialet vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementeve përbërëse;
- c) Fatura me TVSH; fatura të thjeshta tatimore me kasë fiskale ose transfertë bankare;
- d) Fotokopje ose vërtetim i dokumentit të bankës për numrin e llogarisë aktiv të aplikantit.
- e) Certifikata e Origjinës së pajisjeve nga Italia.

APLIKIMI PËR MASAT 1-6.

Aplikimi fillon me paraqitjen nga aplikanti/përfaqësuesi të kartës së identitetit / pasaportës biometrike. Në rastet kur aplikimi kryhet nga përfaqësuesi ligjor, në sistem, regjistrohen të dhënat e aplikantit. Në rastet kur aplikimi kryhet nga portali e-Albania, të dhënat e aplikantit merren automatikisht në kohë reale nga ndërveprimi me regjistrat elektronik. Në sistem, mbi bazën e deklaramit të aplikantit / përfaqësuesit, pranuesi i aplikimit ose vetë aplikanti regjistron dhe shfaqen në formularin e aplikimit:

1. Masa mbështetëse;
2. Të dhënat e kartës së identitetit të aplikantit (në rast kur ka përfaqësues, të dhënat në formular të jenë ato të aplikantit);
3. Statusi nëse aplikanti ka NIPT aktiv;
4. Vendodhja e aplikimit;
5. Sasia e aplikuar (krerë/koshere/sipërfaqja në ha/litra/kg peshk);
6. Vlera e aplikimit;
7. Numër kontakti;
8. Konfirmimi për raste kur aplikanti është i regjistruar në QKB, nuk është debitor ndaj Drejtorisë së Tatimeve.



9. Të dhëna për sigurimet shoqërore koherente, nëse janë paguar në momentin e aplikimit

10. Kodi i aplikimit dhe koha e regjistrimit në sistem, të cilat gjenerohen automatikisht nga sistemi;

11. Aplikanti pranon që të dhënat e tij personale të përdoren vetëm për qëllim të këtij aplikimi. AZHBR garanton mbrojtjen e të dhënave personale të aplikantëve sipas ligjeve në fuqi.

12. Aplikanti informohet se nuk mund të përfitojë nëse është debitor ndaj AZHBR-së, dhe/ose MBZHR- së dhe/ose nuk ka derdhur detyrimet koherente për sigurimet shoqërore. Afati përfundimtar për dorëzim dokumenti është data 7.6.2019.

13. Nënshkrimi i aplikantit/përfaqësuesit ligjor dhe pranuesi i aplikimit.

Procedura e aplikimit përfundon me printimin në dy kopje të Formularit të Aplikimit i cili firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi dhe pranuesi i aplikimeve. Një kopje e merr aplikanti dhe kopja tjetër depozitohet në dosjen e aplikimit.

Procedura e aplikimit nga portali e-Albania, përfundon me dërgimin me sukses të formatit elektronik të formularit të aplikimit.

VII. PROCEDURA QË DO TË NDIQET PËR PËRZGJEDHJEN, VERIFIKIMIN DHE PAGESAT PËR MASAT MBËSHTETËSE ME NR. 1–6

1. Përveç sa përcaktohet në kreun IV- Aplikimi on-line, aplikimi për masën mbështetëse 1, bëhet mbi bazën e numrit të deleve dhe/ose dhive të tufës bazë ekzistuese, të vërtetuar nga sistemi RUDA, ndërsa për masën 2 dhe 4 bëhet mbi bazën e parashikimit për sasitë përkatëse të qumështit dhe açuqeve dhe/ose sardeleve. Financimi për masën 1, do të bëhet sipas numrit faktik të tufës bazë, në momentin e verifikimit, ndërsa për masat 2 dhe 4 do të bëhet sipas sasive faktike të vërtetuara me faturat përkatëse.

2. Me përfundimin e fazës së aplikimit, sistemi gjeneron automatikisht listat e aplikuesëve për çdo masë mbështetëse, sipas parimit “Kush vjen i pari renditet i pari”.

3. Me përfundimin e aplikimeve dhe kontrollit administrativ të dokumenteve që gjenerohen online, AZHBR-ja shpall brenda 10 ditëve pune, listën e aplikimeve të kualifikuara me vizën e

financimit në faqen zyrtare të saj www.azhbr.gov.al si dhe listën e printuar në të gjitha pikat e pranimit të aplikimeve.

4. Për aplikantët për masat nr. 2 dhe 4 pagesat bëhen sipas parimit: “Paguhet i pari kush dorëzon faturat i pari”, deri në përfundimin e fondit të parashikuar për masën përkatëse. Për këto masa faturat duhet të dorëzohen në AZHBR të shoqëruara me dokumentacionin e kërkuar nëpërmjet postës zyrtare ose direkt në zyrat qendrore të AZHBR-së nëpërmjet zyrës së protokollit në adresën: AZHBR, rruga “Muhamet Gjollësja”, nr. 56. Çdo dorëzim faturash i paplotësuar me të gjitha dokumentet shoqëruese nuk do të konsiderohet në radhë për pagesë derisa të plotësohet i gjithë dokumentacioni i kërkuar.

5. Të gjithë aplikantët, përfshirë edhe ata me mangësi në aplikim, sipas evidentimeve në listat e shpallura, kanë afat deri në 7.6.2019, të dorëzojnë dokumentet e kërkuar në agropikën më të afërt ose në zyrat qendrore të AZHBR-së, ose me Postë në zyrat qendrore të AZHBR-së.

Pranuesi i aplikimeve për çdo dokument të paraqitur nga aplikanti/përfaqësuesi ligjor apo çdo dokument tjetër të gjeneruar nga regjistrat publik, bën skanimin dhe ngarkimin në sistem të dokumentacionit, i cili bëhet pjesë e dosjes së aplikimit.

6. Dosja origjinale transferohet nga zyrat e aplikimit në AZHBR përmes protokollit në Sektorin e SPAP/AZHBR;

7. DPAP/SPAP bën kontrollin administrativ të dokumentacionit, si të atyre që gjenerohen nga sistemi on-line dhe të atyre që ndodhen në dosjen e aplikimit dhe në përputhje me kriteret, aprovon/skualifikon aplikimet përkatëse.

8. Grupi i verifikimit në prani të aplikantit ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson formularin e verifikimit sipas masës përkatëse. Formulari i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast aplikanti/përfaqësuesi ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë.

9. Kur grupi i verifikimit ka mendime të ndryshme në lidhje me gjetjet faktike në terren, një ekip i Drejtorisë së Kontrollit të AZHBR-së qendër, bën rivefikim të rastit, vendimi i argumentuar i të cilit është i pa kontestueshëm



administrativisht nga palët.

10. Në momentin e verifikimit aplikanti /përfaqësuesi i dorëzon grupit të verifikimit dokumentet e nevojshme të parashikuara në këtë udhëzim.

11. Procedurat e funksionimit të procesit të aplikimit dhe verifikimeve përcaktohen në Manualin e Procedurave të Implementimit të Skemave Kombëtare 2019.

Në këtë manual, brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i aplikimeve, përcaktohen edhe afatet konkrete për shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve, shpalljen e listës përfundimtare të fituesve dhe kohën e disbursimit të fondeve të fermerët.

Lëvizja e vizës së financimit

Nëse nga “Kontrolli administrativ” dhe “Kontrolli në terren”, rezultojnë aplikime të refuzuara nga AZHBR-ja për mosplotësim të kriterëve të përfitimit apo moskryerje të investimit, bëhet plotësimi i fondit me fitues të tjerë të masës nga aplikantët e radhës.

Për projektet e skualifikuara nga kontrollet administrative dhe në terren, AZHBR-ja njofton aplikantit duke bashkëngjitur edhe arsyen e skualifikimit.

VIII. KRITERET, APLIKIMI DHE DOKUMENTET E NEVOJSHME PËR MASAT 7–10.

Shpenzime të papranueshme për masat 7–10:

- blerje e truallit apo ndërtesë;
- shpenzime operative si transporti i makinerive dhe linjave të ndryshme, elektriciteti, uji, gazi, mirëmbajtje, amortizim dhe kostot e qirasë etj.
- detyrimet doganore dhe të importit ose çdo tarifë që ka efekt të njëjtë;
- blerje, qira ose lizing për tokën apo ndërtesat ekzistuese;
- gjoha apo detyrime gjyqësore;
- kostot operative të aktivitetit;
- makineri dhe pajisje të përdorura;
- detyrime bankare si kosto garancish e të tjera të ngjashme;
- kontributet në natyrë;
- kosto të shkëmbimit valutor;
- shpenzime të kryera në objekt para lidhjes së kontratës me AZHBR-në;
- kosto promovimi për të bërë publik produktin;

- shpenzimet e përgjithshme si hartimi i biznesplanit, tarifat e inxhinierëve, arkitektëve, studime fizibiliteti, patenta, licenca etj.;

- lizing operacional/financiar për makineri /pajisje;

- aplikuesi i cili ka dhe menaxhon mbi 25% kapital publik në sipërmarrjen e vet;

- pagesa e TVSH-së.

MASA 7. Blerje e makinerive dhe pajisjeve për vjeljen e ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.

i. Kriteret e përfitimit:

a) **Përfitues** të kësaj mase mbështetëse mund të jenë:

-Fermerë individual me NIPT aktiv fermeri;

-Subjekte me status fizik, juridik ose SHBB-së të regjistruar në QKB (NIPT/NUIS aktiv) për aktivitetin që aplikojnë;

b) Përfitojnë aplikantët e qarqeve, sipas aneksit 1;

c) Për aplikimet me vlerë investimi të lejuar mbi 1 milion lekë, të ketë plan biznesin e detajuar 5-vjeçar, sipas modelit standard, të përcaktuar në aneksin 7 dhe 7.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi:

- NPV, duhet të dalë ≥ 0 .

- IRR duhet të dalë $\geq$ Norma e skontimit.

- Norma e skontimit që do të përdoret për përllogaritjen e NPV-së, është norma e obligacioneve të thesarit 2 vjeçare të pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankandin e fundit para hapjes së aplikimeve.

- Në rast se nuk plotësohen këto kriteret, ose nuk është plotësuar plan biznesi standard, aplikimi skualifikohet.

d) Aplikanti të ketë jo më pak 0.2 ha ullishta në prodhim;

e) Toka të jetë në pronësi të aplikantit dhe/ose me qira për të paktën 5 vjet nga momenti i aplikimit;

f) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR-së, MBZHR-së dhe Tatimeve;

g) Aplikanti nuk duhet të jetë në ndjekje penale;

h) Aplikanti nuk duhet të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

i) Aplikanti nuk duhet të jetë klasifikuar si kredimarrës me probleme (3–4,6);

j) Pajisjet duhet të jenë të reja dhe me origjinë nga Italia.



ii. Aplikimi

Periodha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 22.4.2019 deri më 17.5.2019.

Aplikimet për mbështetje financiare për këtë skemë dorëzohen në AZHBR-Qendër, adresa: rruga “Muhamet Gjollesha”, nr. 56. Dokumentacioni i dorëzuar firmoset/vulose dhe dorëzohet në një zarf të mbyllur. Në zarf shkruhet masa e mbështetjes, emri i aplikantit /subjektit dhe adresa.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Formulari i aplikimit sipas aneksit 8;
2. Plotëson regjistrin e fermës, sipas aneksit 3.
3. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikantit apo përfaqësuesit ligjor të firmosur dhe të ortakëve;
4. Dokumenti i dakordësisë së anëtarëve të SHBB-së apo ortakëve të subjektit para noterit, për objektin që aplikon;
5. Fotokopje të NIPT-it;
6. Dokumenti i pronësisë/qiramarrjes së tokës (original ose fotokopje e noterizuar);
7. Plan biznesin e detajuar 5-vjeçar të printuar dhe në CD, sipas modelit standard të aneksit 7 dhe 7.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi (për investimet me vlerë më të vogël se 1 milion lekë nuk kërkohet Plan biznesi);
8. 3 oferta origjinale me firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me QKB-të përkatëse të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin dhe me njëri-tjetrin;

9. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit. Për aplikantët me NIPT fermeri vërtetimi i pagesës koherente të kontributeve shoqërore, shoqërore shëndetësore etj., nga Instituti i Sigurimeve;

10. Dëshminë e penalitetit;

11. Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria që aplikanti/subjekti nuk është nën gjykim/hetim;

12. Raportin e kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë;

Pranohet për dokument pronësie një nga dokumentet e mëposhtëm:

- Certifikatë pronësie, e shoqëruar me hartën

treguese dhe kartelën e pasurisë së paluajtshme, e rifreskuar jo më herët se 3 muaj para aplikimit;

- Akti i marrjes së tokës në pronësi (AMTP), sipas legjislacionit për ndarjen e tokës bujqësore, bashkëlidhur me fragmentin e hartës kadastrale, të vërtetuar nga DAMT-ja ose njësi administrative ku ndodhet ngastra.

Në të dyja rastet, kur aplikuesi është një nga anëtarët e familjes bujqësore dhe pronësi i takon familjes bujqësore, është e nevojshme dakordësia para noterit e bashkëpronarëve të familjes bujqësore.

Kur aplikuesi merr tokë me qira:

- Kontratë qiraje me akt noterial ose një dokument të ligjshëm të nënshkruar mes palëve në prani të noterit. Afati i qiradhënies të jetë jo më pak se pesë vjet, duke përfshirë edhe vitin para aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të dokumentit të identifikimit dhe QKR-së së aplikantit), të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i zyrtar i licencuar.

KRITERET KONKURRUESE

1. Sipërfaqja e tokës të mbjellë me ullinj	60 pikë
2. Biznesi plani	20 pikë
3. Statusi i aplikantit	15 pikë
4. Aplikanti Femër	5 pikë
TOTALI	100 pikë

iii. Vlerësimi

Vlerësimi i aplikimeve bëhet mbi bazën e kriterëve të mëposhtme:

Për sipërfaqen e mbjellë me ullinj (Max 60 pikë):

Vlerësimin maksimal për sipërfaqen e fiton aplikimi me sipërfaqen maksimale të mbjellë me ullinj, të tjerët vlerësohen në përpjesëtim të drejtë me këtë sipërfaqe.

Aplikimet me sipërfaqe më të vogla llogariten në mënyrë proporcionale sipas formulës:

$X = \text{Sipërfaqja për të cilën aplikon (në dynym)} * 60 / \text{sipërfaqen maksimale}$.

Biznesi plani/projekti teknik (Max 20 pikë):

- Merr 20 pikë biznesi plani i konceptuar qartë me të gjithë elementet përbërëse.

- Aplikantët e tjerë vlerësohen me 10 pikë.



- Aplikanti me vlerë investimi të lejuar nën 1 milion lekë përfiton pikët max të biznes planit.

Për statusin e aplikantit (Max 15 pikë):

- Subjekte me status juridik/ SHBB 15 pikë
- Subjekte me status fizik 12 pikë
- Fermer individual 10 Pikë

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve dhe për aplikantët me pikë të barabarta renditet i pari ai që vjen i pari.

iv. Kërkesa për financim

Pas blerjes së makinerive dhe/ose pajisjeve për vjeljen e ullirit, aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën për pagesë, sipas aneksit 9;
2. Faturën/faturat tatimore të blerjes së makinerive/pajisjeve, shoqëruar me specifikimet teknike, dhe vlerën ekonomike të elementeve përbërëse;
3. Aktzhdoganimin nëse makineritë/pajisjet vijnë nga jashtë vendit.
4. Transaksionin bankar dhe/ose SËIFT-in për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi te shitësi;
5. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë. Për aplikantët me NIPT fermeri vërtetimi i pagesës koherente të kontributeve shoqërore shëndetësore etj., nga Instituti i Sigurimeve;

6. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

7. Certifikatën e origjinës të makinerive/pajisjeve nga Italia;

Faturat/aktzhdoganimet me data para datës së lidhjes së kontratës me AZHBR-në janë të papranueshme.

MASA 8. Blerje e makinerive dhe pajisjeve për prodhimin e vajit të ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt.

i. Kriteret e përfitimit:

a) **Përfitues** të kësaj mase mbështetëse mund të jenë, subjekte me status fizik, juridik ose SHBB-së së regjistruar në QKB (me NIPT aktiv) për aktivitetin që aplikojnë;

b) Ndërtesa që do të përdoret për investimet, të jetë në pronësi, ose e marrë me qira për një periudhë mbi 9 vjet nga momenti i aplikimit), në emër të aplikantit/subjektit aplikues. Kontrata e qirasë, bazohet në dispozitat e ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, nenet 826–840. Kontrata e qirasë për pasuritë e paluajtshme me natyrë bujqësore për një periudhë mbi 9 vjet, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet në regjistrin publik;

c) Aplikantët të cilët nuk kanë në pronësi/qira ambiente për instalimin e linjës nuk janë të pranueshëm;

d) Të ketë plan biznesin e detajuar 5-vjeçar, sipas modelit standard, të përcaktuar në aneksit 7 dhe 7.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi:

NPV, duhet të dalë ≥ 0 ;

IRR duhet të dalë $\geq$ Norma e skontimit.

Norma e skontimit që do të përdoret për përlllogaritjen e NPV-së, është norma e obligacioneve të thesarit 2 vjeçare të pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankandin e fundit para hapjes së aplikimeve.

Në rast se nuk plotësohen këto kriteret, ose nuk është plotësuar plan biznesi standard, aplikimi skualifikohet;

e) Investimi për të cilin aplikanti është kualifikuar, nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës;

f) Makineritë dhe pajisjet duhet të jenë të reja;

g) Për investimet ku masa e financimit është me vlerë mbi 10 milionë lekë, investimi përkatës të jetë i siguruar të paktën deri në vlerën e financimit nga AZHBR-ja;

h) Aplikanti nuk duhet të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

i) Aplikanti nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

j) Aplikanti nuk duhet të jetë klasifikuar si kredimarrës me probleme (3–4,6);



k) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR, MBZHR dhe Tatimeve;

l) Pajisjet duhet të jenë të reja dhe me origjinë nga Italia.

ii. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 22.4.2019 deri më 17.5.2019.

Aplikimet për mbështetje financiare për këtë skemë dorëzohen në AZHBR-Qendër, adresa: rruga “Muhamet Gjollësja”, nr. 56. Dokumentacioni i dorëzuar firmoset /vulohet dhe dorëzohet në një zarf të mbyllur. Në zarf shkruhet masa e mbështetjes, emri i aplikantit/subjektit dhe adresa. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Formulari i aplikimit sipas aneksit 8;
2. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikantit apo përfaqësuesit ligjor të firmosur dhe të ortakëve;
3. Dokumenti i pronësisë/qiramarrjes së ndërtesës lëshuar nga ZRPP shoqëruar me harte dhe kartelë pasurie të rifreskuar të lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit. Ndërtesa që do të përdoret për investimet, të jetë në pronësi, ose i marrë me qira për një periudhë mbi 9 vjet nga momenti i aplikimit), në emër të subjektit aplikues. Kontratat mbi 9 vjet duhet të jene të regjistruara në ZRPP sipas ligjit;
4. Dëshminë e penaltetit;
5. Vërtetim nga gjykata dhe prokuroria që aplikanti/subjekti nuk është nën gjykim/hetim;
6. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga aplikimi;
7. Plan biznesin e detajuar 5-vjeçar të printuar dhe në CD, sipas modelit standard të aneksit 7 dhe 7.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;
8. 3 oferta origjinale me firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me QKB-të përkatëse të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin dhe me njëri-tjetrin.

Faturat/aktzhdoganimet me data para datës së lidhjes së kontratës me AZHBR-në janë të papranueshme.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të

dokumentit të identifikimit), të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më vonë se 3 muaj nga data e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

KRITERET KONKURRUESE

- | | |
|--|-----------------|
| 1. Kapaciteti përpunues i makinerisë /pajisjes | 55 pikë |
| 2. Konceptimi i biznes planit | 20 pikë |
| 3. Statusi i aplikantit | 20 pikë |
| 4. Aplikant femër | 5 pikë |
| TOTALI | 100 pikë |

iii. Vlerësimi

Vlerësimi i aplikimeve bëhet mbi bazën e kriterëve të mëposhtme:

Kapaciteti përpunues i makinerisë /pajisjes (Max 55 pikë):

Vlerësimin maksimal e merr aplikimi me makinerinë/pajisjen me kapacitet më të lartë (sasi/orë) 55 pikë.

Për aplikimet e tjera do të përllogaritet me formulën $X = \text{kapaciteti faktik} * \text{pikët maksimale (55)} / \text{kapacitetin maksimal}$.

Vlerësimi për biznesplanin (Max 20 pikë):

- Merr 20 pikë biznesplanin i konceptuar qartë me të gjithë elementet përbërëse.

- Aplikimet e tjera vlerësohen me 10 pikë.
- Për statusin e aplikantit (Max 20 pikë):
- SHBB 20 pikë
- Subjekte me status juridik 15 pikë
- Subjekte me status person fizik 10 pikë

Aplikantë femër:

Aplikantët femra marrin 5 pikë

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve dhe për aplikantët me pikë të barabarta renditet i pari ai që vjen i pari.

iv. Kërkesa për financim

Pas blerjes së makinerive dhe pajisjeve për prodhimin e vajit të ullirit, aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesën për pagesë, sipas aneksit 9;
2. Faturën/faturat tatimore të blerjes së makinerive/pajisjeve, shoqëruar me specifikimet



teknike, dhe vlerën ekonomike të elementeve përbërëse;

3. Për investimet ku masa e financimit është me vlerë mbi 10 milionë lekë, dokumenti i sigurimit të investimit nga një kompani sigurimi, deri në vlerën e financimit nga AZHBR-ja.

4. Aktzhdoganimin nëse makineritë/pajisjet vijnë nga jashtë vendit.

5. Transaksionin bankar dhe/ose SËIFT-in për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi te shitësi.

6. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë; vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

7. Certifikata e origjinës të makinerive/pajisjeve nga Italia.

8. Vërtetim nga AKU-ja, që konfirmon përmbushjen e standardeve përkatëse për sigurinë ushqimore.

Faturat/aktzhdoganimet me data para datës së lidhjes së kontratës me AZHBR-në janë të papranueshme.

MASA 9. Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 10 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga Programi IPARD II.

i. Kriteret e përfitimit:

a) **Përfitues** të kësaj mase mbështetëse mund të jenë subjekte me status fizik, juridik ose SHBB-së së regjistruar në QKB për aktivitetin që aplikojnë;

b) Investime të pranueshme janë investimet jashtë fermës, por në zona rurale;

c) Të ketë plan biznesin e detajuar 5-vjeçar, sipas modelit standard, të përcaktuar në aneksin 7 dhe 7.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi:

- NPV, duhet të dalë ≥ 0 .

- IRR duhet të dalë $\geq$ Norma e skontimit.

- Norma e skontimit që do të përdoret për përllogaritjen e NPV, është norma e obligacioneve të thesarit 2 vjeçare të pranuar

nga Banka e Shqipërisë në ankandin e fundit para hapjes së aplikimeve.

- Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plan biznesi standard, aplikimi skualifikohet.

d) Investimi, në përfundim të tij duhet të përmbushë standardet në fushën përkatëse lidhur me akomodimin;

e) Punimet e ndërtimit, materialet dhe produktet duhet të respektojnë karakteristikat, arkitektonike, dhe traditën për fshatin/qarkun përkatës;

f) Të ketë projektin arkitektonik dhe konstruktiv, preventivin origjinal, dhe një përshkrim të investimit;

g) Të ketë 6–10 dhoma;

h) Aplikanti nuk duhet të jete klasifikuar si kredimarrës me probleme (3–4,6);

i) Aplikanti nuk duhet të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

j) Aplikanti nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

k) Aplikanti nuk duhet të jete debitor ndaj AZHBR-së, MBZHR-së dhe Tatimeve;

l) Investimi nuk duhet të fillojë para lidhjes së kontratës. Leja e ndërtimit/rikonstruksionit sigurohet para lidhjes së kontratës, por jo më vonë se data 7.6.2019.

Investime të pranueshme për këtë masë:

1. Ndërtim/rikonstruksion të ndërtesave në zona rurale dhe/ose shtëpive të vjetra tradicionale, për sigurimin e akomodimit;

2. Sistemet e kondicionimit, ajrimit dhe ventilimit për ambientet e ofrimit të akomodimit dhe/ose ofrimit të ushqimit;

3. Mobilie dhe pajisje për objektet akomoduese, në funksion të bujtinës, si: dollapë, rafte, krevate, TV dhe pajisje kuzhine;

4. Makineri/pajisje për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga biomasa, era, dielli dhe gjeotermale për të plotësuar nevojat e energjisë për aktivitetet e zhvillimit të biznesit.

KRITERET KONKURRUESE

1. Kapaciteti maksimal (10 dhoma)	50 pikë
2. Plani i biznesit	20 pikë
3. Aplikant femër	10 pikë
4. Aplikant me status emigrant	10 pikë



5. Investim në 100 fshatrat 10 pikë
TOTALI 100 pikë

ii. Vlerësimi i aplikimeve:

Kapaciteti maksimal (10 dhoma)

Vlerësimin maksimal e merr aplikimi me kapacitetin maksimal 50 pikë.

Për aplikimet e tjera do të përllogaritet me formulën $X = \frac{\text{kapaciteti aktual} \cdot \text{pikët maksimale}(50)}{\text{kapacitetin maksimal}}$.

Vlerësimi për biznesplanin (Max 20 pikë):

- Merr 20 pikë biznesplanin i konceptuar qartë me të gjithë elementet përbërëse.

- Aplikimet e tjera vlerësohen me 10 pikë.

Aplikantë femër:

Aplikantët femra marrin 10 pikë

Aplikant me status emigrant 10 pikë

Investim në 100 fshatrat 10 pikë

Marrin 10 pikë të gjitha investimet që do të kryhen në 100 fshatrat, sipas aneksit 10.

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve dhe për aplikantët me pikë të barabarta renditet i pari ai që vjen i pari.

iii. Aplikimi

Periudha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 22.4.2019 deri më 17.5.2019.

Aplikimet për mbështetje financiare për këtë skemë dorëzohen në AZHBR-Qendër, adresa: rruga “Muhamet Gjollësja”, nr. 56. Dokumentacioni i dorëzuar firmoset/vulohet dhe dorëzohet në një zarf të mbyllur. Në zarf shkruhet masa e mbështetjes, emri i aplikantit/subjektit dhe adresa.

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Formulari i aplikimit, sipas aneksit 8;

2. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikantit apo përfaqësuesit ligjor të firmosur dhe të ortakëve;

3. Fotokopje të NIPT-it;

4. Dokumenti i pronësisë/qiramarrjes së tokës/ndërtesës lëshuar nga ZRPP-ja shoqëruar me hartë dhe kartelë pasurie të rifreskuar të lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit. Ndërtesa/toka që do të përdoret për investimet, të jetë në pronësi, ose i marrë me qira për një periudhë mbi 9 vjet nga momenti i aplikimit, në emër të aplikantit/subjektit aplikues. Kontratat mbi 9 vjet duhet të jenë të regjistruara në ZRPP sipas ligjit;

5. Certifikata e rezidencës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit;

6. Projektin arkitekturor të firmosur dhe vulosur/firmë digjitale nga arkitekti, projektin konstruktiv dhe preventivin origjinal të firmosur dhe vulosur/firmë digjitale, nga një inxhinier i licencuar për ndërtim dhe rikonstruksion. Dokumentacioni i mësipërm duhet të dorëzohet nëse është i detyrueshëm nga legjislacioni në fuqi;

7. Plan biznesin e detajuar 5-vjeçar të printuar dhe në CD, sipas modelit standard të aneksit 7 dhe 7.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;

8. Përshkrimi i investimit;

9. Dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e lejes së ndërtimit/rikonstruksionit sipas legjislacionit në fuqi. Ky dokument mund të dorëzohet edhe para lidhjes së kontratës por jo më vonë se data 7.6.2019;

10. 3 oferta origjinale shoqëruar, me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin dhe me njëri-tjetrin;

11. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit;

12. Dëshminë e penalitetit;

13. Vërtetim nga Gjykata/Prokuroria që aplikanti/subjekti nuk është në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

14. Raportin e kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë;

15. Për aplikantin me statusin emigrant, kopje të firmosur të certifikatës së rezidencës permanente ose pasaportës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose pasaportës biometrike, formularin e regjistrimit në QKB të ofertuesve) të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të



huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim sipas formatit të aneksit 9. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore, shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim ose rikonstruksion);

- Faturën/faturat tatimore punimeve/pajisjeve, shoqëruar me vlerën ekonomike të elementeve përbërëse etj.;

- Aktzhdoganimin për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën të elementeve përbërëse;

- Transaksionin bankar dhe/ose SËIFT-in për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti te shitësi.

- Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;

- Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë.

Faturat/aktzhdoganimet me data para datës së lidhjes së kontratës me AZHBR-në janë të papranueshme.

MASA 10. Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga Programi IPARD II.

i. Kriteret e përfitimit:

a) **Përfitues** të kësaj mase mbështetëse mund të jenë subjekte me status fizik, juridik ose SHBB-së së regjistruar në QKB (me NIPT/NUIS aktiv) për aktivitetin që aplikojnë;

b) Investime të pranueshme janë investimet të cilat përfshijnë çdo lloj investimi në shërbim të agroturizmit si veprimtari pritëse, që zhvillohet në një fermë ose njësi tjetër agrokulturore me qëllim për të tërhequr vizitorë, duke u

mundësuar atyre pjesëmarrjen në veprimtari të bujqësore apo veprimtari të tjera ndihmëse, që zhvillohen në atë mjedis bujqësor. Të pranueshme për mbështetje janë investimet që lidhen me akomodimin, ofrimin e ushqimit e pijeve dhe veprimtari argëtuese/çlodhëse, të lidhura me fermën ose mjedisin përreth;

c) Investimi në përfundim duhet të përmbushë standardet në fushën përkatëse në përputhje me akomodimin, sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen mjedisore.

d) Punimet e ndërtimit, materialet dhe produktet duhet të respektojnë karakteristikat, arkitektonike, dhe traditën për fshatin/qarkun përkatës;

e) Të ketë projektin arkitektonik dhe konstruktiv, preventivin origjinal, dhe një relacion shpjegues të investimit;

f) Të ketë planin biznesin e detajuar 5-vjeçar, sipas modelit standard, të përcaktuar në aneksin nr.7 dhe nr. 7.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, i cili të plotësojë sa më poshtë:

- NPV duhet të dalë ≥ 0 .

- IRR duhet të dalë $> \text{—}$ Norma e skontimit.

- Norma e skontimit që do të përdoret për përlogaritjen e NPV-së, është norma e obligacioneve 2 vjeçare të thesarit e pranuar nga Banka e Shqipërisë në ankandin e fundit, para hapjes së aplikimeve.

- Në rast të supozimeve të paqarta/pasakta, AZHBR-ja gëzon të drejtën të kërkojë me shkrim informacion shtesë. Nëse nuk arsyetohen dhe mbështeten supozimet me të dhëna faktike të qarta, atëherë ky aplikim skualifikohet.

- Në rast se nuk plotësohen këto kritere, ose nuk është plotësuar plani biznesi standard, aplikimi skualifikohet.

g) Aplikanti nuk duhet të jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtari tjetër të paligjshme;

h) Aplikanti nuk duhet të jetë në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtari tjetër të paligjshme;

i) Aplikanti nuk duhet të jetë debitor ndaj AZHBR-së, MBZHR-së dhe Tatimeve;

j) Investimi nuk duhet të fillojë përpara lidhjes së kontratës;

k) Ndërtimet për akomodim të mos jenë me shumë se dy kate dhe me kapacitet akomodues



6–30 dhoma. Rikonstruksionet e objekteve ekzistuese si kulla ose shtëpi lejohen sipas lartësisë dhe kateve ekzistuese.

l) Aplikanti nuk duhet të jetë klasifikuar si kredimarrës me probleme (3–4,6);

m) Në rastet e ndërtimit projekti duhet të përmbajë pjesën konstruktive, arkitekturore, si dhe renderat.

n) Aplikanti duhet të ketë xhiro vjetore dhe total aktivesh mbi 126.41 milion lekë si dhe numër punonjësish mbi 50 punonjës. Madhësia e aplikantit përcaktohet duke llogaritur dhe kompanitë partnere dhe të lidhura ku aplikanti ka pjesëmarrje mbi 25% të aksioneve.

o) Në përfundim të investimit dhe përpara financimit të investimit, aplikanti duhet të paraqesë “Certifikatën e agroturizmit”, si subjekt i certifikuar agroturizmi.

Aplikimet në lidhje me ndërtimin dhe rikonstruksionin duhet të shoqërohen me një relacion teknik nga arkitekti duke shpjeguar stilin dhe materialet e propozuara në projekt dhe se si ato përshtaten me zonën përreth dhe investimin.

Investime të pranueshme për këtë masë:

5. Ndërtim/rikonstruksion të ndërtesave në zona rurale dhe/ose shtëpive të vjetra tradicionale, për sigurimin e akomodimit.

6. Ndërtimi i ambienteve argëtuese dhe sportive në funksion të ofrimit të shërbimit të akomodimit dhe/ose ushqimit si fusha sporti, kënde lojërash, pishina.

7. Ndërtim/rikonstruksion dhe/ose përshtatjen ndaj standardeve të sigurisë /higjienës të ambienteve për ofrimin / furnizimin / degustimin e ushqimit, si dhe për pika shitje me pakicë për produkte bujqësore dhe artizanale të zonës, muze rural së bashku me investimet në objekte rekreative.

8. Sistemet e kondicionimit, ajrimit dhe ventilimit për ambientet e ofrimit të akomodimit dhe/ose ofrimit të ushqimit.

9. Mobilie dhe pajisje për objektet akomoduese, në funksion të agroturizmit, si: dollapë, rafte, krevate, TV dhe pajisje kuzhine.

10. Ndërtim/rikonstruksion për zhvillimin e veprimtarive tradicionale të artizanatit duke përfshirë, krijimin e punishteve të riparimit apo artizanatit, përfshirë edhe blerjen e pajisjeve për këto punishte.

11. Ndërtim/rikonstruksion ambienteve ndihmëse/pushimi në stane (si: dhoma pushimi, vend për kamping, stola etj.).

12. Investime në funksion të ekoturizmit, si ndërtim dhe/ose makineri/pajisje/mjete për, kampingje, kasolle me materiale natyrore rrethanore, hipizëm, peshkim sportiv në ujëra të brendshme, shëtitje, rafting, ngjitje në mal, biçikleta të tipit mountain bike, varka, kanoe, sisteme elektronike të aksesimit/markimit të shtigjeve.

13. Makineri/pajisje për prodhimin e energjisë së rinovueshme nga biomasa, era, dielli dhe gjeotermale për të plotësuar nevojat e energjisë për aktivitetet e zhvillimit të biznesit.

ii. Aplikimi

Periodha e aplikimit për mbështetje financiare fillon më 22.4.2019 deri më 17.5.2019.

Aplikimet për mbështetje financiare për këtë skemë dorëzohen në AZHBR-Qendër, adresa: rruga “Muhamet Gjollësja”, nr. 56. Dokumentacioni i dorëzuar firmoset /vuloset dhe dorëzohet në një zarf të mbyllur. Në zarf shkruhet Masa e mbështetjes, emri i aplikantit/subjektit dhe adresa. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet:

1. Formulari i aplikimit, sipas aneksit 8;

2. Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës biometrike së aplikantit apo përfaqësuesit ligjor të firmosur dhe të ortakëve;

3. Fotokopje të NIPT-it;

4. Dokumenti i pronësisë/qiramarrjes së tokës/ndërtesës lëshuar nga ZRPP-ja shoqëruar me hartë dhe kartelë pasurie të rifreskuar të lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit. Ndërtesa/toka që do të përdoret për investimet, të jetë në pronësi, ose i marrë me qira për një periudhë mbi 9 vjet nga momenti i aplikimit), në emër të aplikantit/subjektit aplikues. Kontratat mbi 9 vjet duhet të jenë të regjistruara në ZRPP sipas ligjit;

5. Certifikata e rezidencës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit;

6. Projektin arkitekturor të firmosur dhe vulosur/firmë digjitale nga arkitekti, projektin konstruktiv dhe preventivin original të firmosur dhe vulosur/firmë digjitale, nga një inxhinier i licencuar për ndërtim dhe rikonstruksion. Dokumentacioni i mësipërm duhet të dorëzohet nëse është i detyrueshëm nga legjislacioni në fuqi;



7. Renderat dhe relacioni shpjegues nga arkitekti;

8. Plan biznesin e detajuar 5-vjeçar të printuar dhe në CD, sipas modelit standard të aneksit 7 dhe 7.1, bashkëngjitur këtij udhëzimi;

9. Dokumenti origjinal ose fotokopje e noterizuar e lejes së ndërtimit/rikonstruksionit sipas legjislacionit në fuqi. Ky dokument mund të dorëzohet edhe para lidhjes së kontratës por jo më vonë se data 7.6.2019;

10. 3 oferta origjinale shoqëruar, me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me formularin e regjistrimit në QKB të subjekteve ofertuese, me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlefshmërinë e ofertës. Ofertuesit nuk duhet të jenë në konflikt interesi me aplikantin dhe me njëri-tjetrin;

11. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e aplikimit;

12. Raportin e kredimarrësit nga Banka e Shqipërisë;

13. Dëshminë e penalitetit;

14. Vërtetim nga Gjykata/Prokuroria që aplikanti/subjekti nuk është në ndjekje penale për mashtrim, korrupsion apo për çdo lloj veprimtarie tjetër të paligjshme;

15. Për aplikantin me statusin emigrant, kopje të firmosur të certifikatës së rezidencës permanente ose pasaportës nga një shtet tjetër, në momentin e aplikimit;

16. Deklaratë nga aplikanti, ku vërteton respektimin e madhësi së xhiros, totalit të aktiveve dhe numrit të punonjësve, për vitin ushtrimor 2018, bashkë me pasqyrat financiare të certifikuara të ndërmarrjeve ku aplikanti zotëron mbi 25% të aksioneve.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar kur dorëzohet si fotokopje (me përjashtim të kartës së identitetit ose pasaportës biometrike, formularin e regjistrimit në QKB të ofertuesve) të jetë i noterizuar dhe i lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e aplikimit.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar të jetë në gjuhën shqipe ose në rast se është në gjuhë të huaj të jetë i përkthyer nga një përkthyes i autorizuar.

KRITERET KONKURRUESE:

1. Lloji investimit (shumëllojshmëri shërbimesh, akomodim, pajisje etj.)	60 pikë
2. Plani i biznesit	20 pikë
3. Investim në 100 fshatrat	10 pikë
4. Aplikant femër	5 pikë
5. Aplikant me status emigrant	5 pikë
TOTALI	100 pikë

iii. Vlerësimi i aplikimeve:

Lloji i investimit shumëllojshmëri shërbimesh, akomodim, pajisje etj.

60 pikë

Vlerësimin maksimal e merr aplikimi me mbi

3 lloje investimesh 60 pikë

Aplikime me 2 lloje investimesh 50 pikë

Aplikime me 1 investim 40 pikë

Vlerësimi për biznesplanin (Max 20 pikë):

- Merr 20 pikë biznesplanin i konceptuar qartë me të gjithë elementet përbërëse.

- Aplikimet e tjera vlerësohen me 10 pikë.

Investim në 100 fshatrat 10 pikë

Marrin 10 pikë të gjitha investimet që do të kryhen në 100 fshatrat, sipas aneksit 10

Aplikantë femër:

Aplikantët femra marrin 5 pikë

Aplikant me status emigrant 5 pikë

Projektet vlerësohen me pikë, sipas shkallës së plotësimit të kriterëve. Projektet e vlerësuara nën 60 pikë nuk kualifikohen. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve dhe për aplikantët me pikë të barabarta renditet i pari ai që vjen i pari.

iv. Dokumentacioni dhe kërkesa për financim

Aplikanti paraqet pranë AZHBR-së kërkesën për financim. Financimi do të realizohet sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.

Së bashku me kërkesën për financim sipas formatit të aneksit 9, aplikanti paraqet edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim ose rikonstruksion);

- Faturën/faturat tatimore për investimet e pranueshme sipas aneksit të kontratës, shoqëruar me vlerën ekonomike të elementeve përbërëse;

- Aktzhdoganimin për pajisjet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën e elementeve përbërëse;



- Transaksionin bankar dhe/ose fotokopje e SËIFT-in për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikanti te shitësi.

- Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka përmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetësore etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë;

- Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë;

Faturat/aktzhdoganimet me data para datës së lidhjes së kontratës me AZHBR-në janë të papranueshme.

IX. PROCEDURAT E APLIKIMIT, PËRZGJEDHJES, VERIFIKIMIT DHE EKZEKUTIMIT TË PAGESAVE PËR MASAT 7-10

1. AZHBR-ja, nëpërmjet Zyrës së Protokollit, pranon dosjet e aplikimit me dokumentacionin përkatës dhe plotëson formularin e pranimit. Një kopje e këtij formulari i jepet aplikantit.

2. Dosja e aplikimit duhet të përmbajë të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas masës mbështetëse të firmosur/vulosur.

3. Aplikantët informohen zyrtarisht lidhur me mangësitë në dokumentacion të administruar në dosjen e aplikimit, dhe u lihet një afat 10 ditë pune për plotësimin dhe dorëzimin e tyre zyrtar në AZHBR. Dorëzimi i dokumenteve pjesorë apo përtej afatit të përcaktuar, është kriter skualifikimi (më përjashtim të dokumentit të lejes së ndërtimit).

4. Mbas plotësimit të dosjes dhe përputhshmërisë së kriterëve, aplikimet vlerësohen me pikë, sipas kriterëve të vlerësimit për çdo masë përkatëse.

5. Aplikantët renditen sipas rendit zbritës të pikëve. Për aplikimet me pikë të barabarta, zbatohet parimi “Kush vjen i pari renditet i pari”.

6. Për aplikimet e renditur mbi vijën, referuar tavaneve të financimit bëhet kontrolli paraprak në terren, dhe nëse rezultojnë në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim, AZHBR-ja lidh kontratën përkatëse dhe shpall listën e fituesve.

7. Grupi i kontrollit në terren bën verifikimin në vend të aplikimit, duke lajmëruar paraprakisht aplikantin për praninë e tij ose të përfaqësuesit ligjor të pajisur me prokurë.

8. Grupi i kontrollit në prani të aplikantit ose të përfaqësuesit ligjor, kryen verifikimet e nevojshme dhe plotëson raportin e verifikimit sipas masës përkatëse. Raporti i verifikimit firmoset nga aplikanti/përfaqësuesi i tij ligjor dhe gjithë grupi i verifikimit. Për çdo rast aplikanti ose ndonjë përfaqësues i grupit të verifikimit mund të bëjë observimet e nevojshme dhe të firmosë për to.

Mangësi skualifikuese, për masat 7-10 janë si më poshtë:

- aplikimet e dorëzuara pas përfundimit të afatit;

- mungesa e Planit të Biznesit në të dyja format, elektronike (CD) dhe i printuar;

- mospërdorimi i modelit standard të Planit të Biznesit;

- mungesa e tre ofertave origjinale me datë, firmë dhe vulë për çdo lloj investimi, të shoqëruar me specifikimet teknike të krahasueshme dhe vlerën për çdo element përbërës, si dhe vlefshmërinë e ofertës;

- ofertuesit janë në konflikt interesi (palë të lidhura) me aplikuesin ose me njëri-tjetrin;

- paraqitja e dokumenteve/deklarimeve të rreme (fiktive).

Aplikantët informohen zyrtarisht lidhur me mangësitë e dokumenteve (që nuk janë pjesë e dokumenteve të renditura më sipër) në dokumentacion të administruar në dosjen e aplikimit, dhe u lihet një afat 10 ditë pune për plotësimin dhe dorëzimin e tyre zyrtar në AZHBR. Dorëzimi i dokumenteve pjesorë apo përtej afatit të përcaktuar është kriter skualifikimi, me përjashtim të dokumentit të lejes së ndërtimit, e cila duhet paraqitet para lidhjes së kontratës, por jo më vonë se data 7.6.2019.

Lëvizja e vizës së financimit

Nëse nga “Kontrolli administrativ” dhe “Kontrolli në terren”, rezultojnë aplikime të refuzuara nga AZHBR-ja për mosplotësim të kriterëve të përfitimit apo moskryerje të investimit, bëhet plotësimi i fondit më fitues të tjerë të masës nga aplikantët e radhës.

Për projektet e skualifikuara nga kontrollet administrative dhe në terren, AZHBR-ja njofton aplikantin duke bashkëngjitur edhe arsyen e skualifikimit.



X. Pagesa e vlerës së palikuiduar për vitin 2018 dhe mbështetja për UBT-në

1. Në zbatim të VKM-së nr. 128, datë 13.3.2019, të ndryshuar, pika 6, për pagesën e vlerës së palikuiduar për subjektet e shpallur fitues nga AZHBR-ja, në zbatim të vendimit nr. 72, datë 7.2.2018 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2018”, të ndryshuar, hartohet shtesa e kontratës midis AZHBR-së dhe subjekteve, e cila bazuar në Kodin Civil, neni 690, do të shtrijë efektet e saja si pjesë integrale dhe e pandarë e kontratës bazë. Palët me nënshkrimin e shtesës së kontratës, njohin dhe bien dakord për faktin se ndryshimet e propozuara nuk kanë si qëllim ndryshimin e kushteve thelbësore të kontratës, por duke gjetur të argumentuar dhe të provuar kërkesën e subjekteve kontraktore, përcakton se afati përfundimtar i realizimit të pagesave të mbartura është data 30.6.2019.

2. Në zbatim të VKM-së nr. 128, datë 13.3.2019, të ndryshuar, pika 3, për mbështetjen e fermës didaktike eksperimentale të UBT-së, zbatohen procedurat e mëposhtme:

- AZHBR-ja njofton zyrtarisht UBT-në menjëherë pas miratimit të këtij udhëzimi mbi fondin që do të menaxhojë për projektin “Mbështetje për fermën didaktike” brenda vitit buxhetor 2019.

- UBT-ja paraqet në AZHBR kërkesën për çeljen e fondit për ekzekutimin e vlerës së plotë faktike të projekteve të zbatimit, së bashku me vendimin përkatës të Bordit të Administrimit të UBT-së, sipas shtojcës 1 të VKM-së nr. 128, datë 13.3.2019, të ndryshuar.

- AZHBR-ja dërgon në MBZHR kërkesën për transferimin e fondeve të kërkuar nga UBT-ja nga llogaria ekonomike 606 “Transferte në buxhetet familjare”, të AZHBR-së në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferta të brendshme”, kapitull 1, të UBT-së, për financimin e projekteve për “Mbështetjen e fermës didaktike”, në përputhje me përcaktimet e ligjit organik të buxhetit.

- Mbas kalimit të fondit përkatës në llogarinë ekonomike 604 “Të tjera transferta të brendshme”, kapitull 1, AZHBR-ja ekzekuton

menjëherë transferimin e vlerës së plotë faktike të projekteve të zbatimit tek UBT-ja, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e këtij fondi.

- UBT-ja raporton në AZHBR çdo datë 10 të muajit pasardhës për përdorimin e fondeve të akorduara.

XI. KONTROLLI PËR ADMINISTRIMIN E FONDIT DHE ÇËSHTJE TË TJERA

1. AZHBR-ja është përgjegjëse për zbatimin, auditimin dhe likuidimin financiar të përfituesve sipas masave të mbështetjes dhe kriterëve të përfitueshmërisë.

2. AZHBR gëzon të drejtën për të kërkuar çdo informacion /dokumentacion shtesë, në rast se e gjykon të arsyeshme brenda kriterëve dhe procedurave të miratuara.

3. Për ofertat dhe faturat në valutë të huaj do të zbatohet kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën e çeljes së thirrjes për aplikim. AZHBR-ja ka të drejtë të bëjë korrigjime aritmetike para kontraktimit, nëse subjektet kanë përdorur kurse të tjera këmbimi. Nëse në ofertë janë përfshirë zëra të listuara në shpenzimet e papranueshme, AZHBR-ja ka të drejtë t'i fshijë para lidhjes së kontratës.

4. Dokumentet e dorëzuara bëhen pronë e AZHBR-së sipas përcaktimeve nga ligji për ruajtjen e dokumentacionit, dhe nuk i kthehen aplikantit.

5. MBZHR-ja, AZHBR-ja dhe AKSHI hartojnë dhe zbatojnë një plan trajnimi me të gjithë stafin që do të përfshihet në procedurën e aplikimit *on line*, me 0 dokumente në aplikim.

6. MBZHR-ja dhe AZHBR-ja hartojnë dhe zbatojnë një plan informimi dhe ndërgjegjësimi me të gjithë grupet e interesit për masat e përfitimit, kriteret dhe kushtet që duhet të plotësojnë të gjithë përfituesit potencialë për të përfituar mbështetje financiare nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

7. Alokimi i fondit sipas masave mbështetëse bëhet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sipas propozimit të AZHBR-së.

8. Në rastet kur numri i aplikuesve të një mase nuk plotëson tavanin e financimit për masën përkatëse, riallokimi i fondeve në masat e tjera bëhet me urdhër të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me propozim të AZHBR-së.

9. Aplikimi, kontrolli administrativ, verifikimi



në terren, autorizimi dhe ekzekutimi i pagesës së aplikimeve përshkruhen në “Manualin e procedurave për implementimin e masave kombëtare”, të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i AZHBR-së.

10. Formularët/raportet e verifikimit në terren, sipas masave mbështetëse, përgatiten nga AZHBR-ja në përputhje dhe në zbatim të këtij udhëzimi.

11. Aplikuesit, të cilët skualifikohen gjatë implementimit të masave mbështetëse, paraqesin ankesën e tyre brenda 10 ditëve pune nga marrja e njoftimit pranë AZHBR-së.

AZHBR-ja, brenda 10 ditëve pune nga marrja e ankesës, bën verifikimin përkatës dhe i jep përgjigje ankimuesit.

12. Për vlerësime të aplikimeve në masat e investimeve, në rastet ku përfshihen zëra punimesh ndërtimore etj., AZHBR-ja mund të kontrakttojë me kohë të kufizuar ekspertë të licencuar të fushës.

13. Mbështetja financiare llogaritet mbi vlerën e faturës tatimore, përjashtuar vlerën e TVSH-së.

14. Në kontratën që AZHBR-ja do të nënshkruajë me aplikuesin fitues, duhet të përcaktohen qartë penalitetet në rastet kur përfituesi i fondeve të masave mbështetëse nuk pranon të kontrollohet prej inspektorëve të AZHBR-së.

15. Në momentin e aplikimit, aplikanti pranon që të dhënat e tij personale të përdoren vetëm për qëllim të këtij aplikimi. AZHBR-ja garanton mbrojtjen e të dhënave personale të aplikantëve sipas ligjeve në fuqi.

16. Në rast të konstatimit të “kundërvajtjeve administrative”, nga ana e përfituesit në drejtim të tjetërsimit të qëllimit për të cilën janë marrë fondet apo mos mbajtjes së dokumentacionit të përdorur për përfitimin e fondeve për një

periudhë 5-vjeçare, AZHBR-ja propozon sanksione të përcaktuara në nenin 39 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

17. Për menaxhimin e fondeve, AZHBR-ja raporton në mënyrë periodike në MBZHR, e cila raporton çdo katërmujor në MFE për ecurinë e realizimit të programit të mbështetjes financiare.

18. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, Ministria e Financës dhe Ekonomisë si dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi

MINISTËR I FINANCEVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

ANEKSET

Aneksi 1: Harta bujqësore për masat mbështetëse

Aneksi 2: Lista e zyrave të aplikimeve

Aneksi 3: Formulari i regjistrimit të fermës

Aneksi 4: Kultivarët e ullirit të regjistruar në katalogun kombëtar

Aneksi 5: Formulari për mbjelljen e ullirit

Aneksi 5.1: Formulari për plotësimin e nr. të bimëve në ullishtat e degraduara

Aneksi 6: Formulari i sistemit ujitës

Aneksi 7: Planbiznesi – pjesa përshkruese

Aneksi 7.1: Planbiznesi – pjesa financiare

Aneksi 8: Formulari i aplikimit për masat 7–10

Aneksi 9: Kërkesa për pagesë

Aneksi 10: Lista e 100 fshatrave



ANEKSI 1. HARTA BUJQËSORE PËR MASAT MBËSHTETËSE

M asat	Emërtimi	QARQET											
		B erat	Di bër	Dur rës	Elba san	F ier	Gjiroka stë r	Ko rçë	Ku kës	Lez hë	Shko dër	Tir anë	Vlorë
1	Tufën bazë të imëta të matrikulluar												
2	Dorëzim qumështi gjedh												
3	Bletë të matrikulluara												
4	Mbështetje açuges dhe ose sardele												
5	Mbjellja e ullinjve												
5/ 1.	Plotësim bimë në ullishtat e vjetra												
6	Përmirësimi i teknikave të ujitjes me pika ullinj												
7	Blerje makineri e pajisje për vjeljen e ullirit												
8	Makineri/pajisje për prodhim vaj ulliri												



ANEKSI 2
LISTA E ZYRAVE TË APLIKIMEVE

Qarku	Nr.	Zyra e aplikimit
Berat	1	AGROPIKA Berat
	2	Zyra e bujqësisë Skrapar
	3	Zyra e bujqësisë Kuçovë
Dibër	1	AGROPIKA Dibër
	2	Zyra e bujqësisë Bulqizë
	3	AGROPIKA Mat
Durrës	1	AGROPIKA Rrashbull, Durrës
	2	Zyra e bujqësisë Krujë
Elbasan	1	AGROPIKA Elbasan
	2	Zyra e bujqësisë Peqin
	3	AGROPIKA Librazhd
	4	Zyra e bujqësisë Gramsh
Fier	1	AGROPIKA Fier
	2	Zyra e bujqësisë Mallakastër
	3	AGROPIKA Lushnje
Gjirokastrë	1	AGROPIKA Gjirokastrë
	2	Zyra e bujqësisë Tepelenë
	3	AGROPIKA Përmet
Korçë	1	Zyra e bujqësisë Devoll
	2	AGROPIKA Pogradec
	3	Zyra e bujqësisë Kolonjë
	4	AGROPIKA Korçë
Kukës	1	AGROPIKA Kukës
	2	Zyra e bujqësisë Has
	3	Zyra e bujqësisë Tropojë
Lezhë	1	AGROPIKA Lezhë
	2	Zyra e bujqësisë Mirditë
	3	Zyra e bujqësisë Kurbin
Shkodër	1	AGROPIKA Shkodër
	2	AGROPIKA Pukë
Tiranë	1	AGROPIKA Tiranë
	2	AGROPIKA Kavajë
Vlorë	1	AGROPIKA Vlorë
	2	AGROPIKA Sarandë
	3	Zyra e bujqësisë Delvinë

**ANEKSI 3. FORMULARI I REGJISTRIT TË FERMËS****Emri:****Atësia:****Mbiemri:****Datëlindja:**

data

muaji

viti

NIPT**Numri personal** (me 10 karaktere) nga karta e identitetit**Tel/cel:****Rr, ndërtesa, hyrja, apartamenti, njësia administrative, bashkia****Fshati:****Njësia administrative****Bashkia****Qarku**



Sipërfaqja e tokës së fermës për vitin bujqësor 2019

Nr.	Kategoritë kryesore të tokës	Sipërfaqja në pronësi	Sip. marrë me qira ose forma të tjera përdorimi	Sip. dhënë me qira ose forma të tjera përdorimi	Sipërfaqja e përdorur gjithsej ***
		m ²			
		A	B	C	D = A + B - C
1	Tokë arë gjithsej (1.1+1.2+1.3)				
1.1	- Tokë arë e përdorur (1.1.1+1.1.2+1.1.3+1.1.4+1.1.5+1.1.6)				
1.1.1	- - Drithëra (grurë, misër, thekër, elb, tërshërë etj.)				
1.1.2	- - Perime gjithsej (përfshihen bostanoret)				
	- - nga e cila në serra				
1.1.3	- - Fasule				
1.1.4	- - Patate				
1.1.5	- - Birre industriale (luledielli, duhan, soje, bime medicinale aromatike dhe erëza gatimi, humulus lupulus (maja Birre) etj.				
1.1.6	- - Foragjere				
1.1.7	- Te tjera				
1.2	- Tokë arë e papërdorur vetëm për një vit (djerr/ugar)*				
1.3	- Tokë arë e papërdorur për dy vjet e më shumë				
2	TOTALI Drufrutore në blloqe (pemë frutore + vreshtë + ullinj + agrume) (2=2.1+2.2+2.3+2.4+2.5+2.6)				
2.1	- Pemë frutore				
2.2	- Ullishta				
2.3	- Agrume				
2.4	- Vresht				
2.5	Fidanishte				
2.6	Drufrutore të degraduar (e papërdorur)				
3	Kopsht shtëpie**				
4	Livadhe e kullota (vetëm në pronësi)				
4.1	- nga e cila livadhe (vetëm në pronësi)				
5	Pyll (vetëm sipërfaqe pylli në pronësi të fermerit)				
6	Tokë jobujqësore (sipërfaqja e zënë me ndërtesa si: (banesë, stalla, ambiente magazinimi jashtë banesës, rezervuar për kultivimin e peshkut etj.)				
7	Sipërfaqja gjithsej e Fermës 7 = (1+2+3+4+5+6)				

* Tokë arë e papërdorur vetëm për një vit (djerr/ ugar) është pjesë e tokës së punueshme (arë) e përfshirë në qarkullim bimor, pa ndonjë qëllim për të prodhuar të korra gjatë vitit bujqësor. Karakteristika themelore e tokës djerr është se ajo lihet një vit për qëllime ripërtëritjeje, normalisht gjatë të gjithë vitit bujqësor. Toka djerr mund të jetë: tokë e zhveshur, në përgjithësi pa bimë; tokë me zhvillim të natyrshëm spontan që mund të përdoret si ushqim për kafshët ose të plugohet; dhe tokë e mbjellë ekskluzivisht për prodhimin e plehut organik të gjelbër.

** Kopsht shtëpie konsiderohet sipërfaqja rrotull banesës, që përdoret kryesisht për kultivimin e produkteve bujqësore me qëllim vetë-konsumi nga drejtuesi i Fermës dhe familja e tij, përgjithësisht është e ndarë nga pjesa tjetër e tokës së punueshme. Sipërfaqe të tilla përdoren kryesisht për prodhimin e perimeve, bishtajoreve të freskëta, patateve, luleve etj. Në kopsht, gjithashtu mund të kultivohen edhe pemë frutore të shpërndara.

*** Sipërfaqja gjithsej(ha) që fermeri përdor gjatë vitit bujqësor referues, përfshin sipërfaqen gjithsej në pronësi plus sipërfaqen e marre me qira minus sipërfaqen e dhënë me qira: sipërfaqen gjithsej e përdorur = sipërfaqe në pronësi + sipërfaqe marre me qira/ sipërfaqe në forma të tjera përdorimi – sipërfaqe e dhënë me qira/ forma të tjera përdorimi.

**Blegtoria**

		Kodi	Krerë
1	Gjedhë gjithsej	28	
1.1	- nga këto lopë	29	
2	Të leshta gjithsej	30	
2.1	- nga këto dele qumështi	31	
3	Të dhirta gjithsej	32	
3.1	- nga këto dhi qumështi	33	
4	Derra gjithsej	34	
4.1	- nga këto dosa	35	

Shënim. Periudhë referuese është dita kur merret informacioni.



**Aneksi 4 KULTIVARET E ULLIRIT TË REGJISTRUAR NË KATALOGUN KOMBËTAR
ULLIRI (OLIVE)**

(Olea Europaea)

Identifikimi i varietetit			Përdorimi	Seleksioneri dhe përgjegjësi	Regjistrimi	Riregjistrimi
Kodi ESHFF	Emri -1	CV/h				
O1341	Kokerrmadhi i Beratit	CV	Try.	Pop.IKUA	Pop	1995
O1342	Kalinjoti	CV	Try.Vaj	Pop.IKUA	Pop	1995
O1343	I bardhi i Tiranës	CV	Try.Vaj	Pop.IKUA	Pop	1995
O1344	Mixani	CV	Try.Vaj	Pop.IKUA	Pop	1995
O1345	Kokerrmadhi i Elbasanit	CV	Try.Vaj	Pop.IKUA	Pop	1995
O1346	I holli i Himarës	CV	Vaj	Pop.IKUA	Pop	1995
O1347	Pula zeqini	CV	Vaj	Pop.IKUA	Pop	1995
O1348	Frantojo	CV	Vaj	ITALI .IKUA	1960	1995
O1349	Lecino	CV	Vaj	ITALI. IKUA	1960	1995
O13410	Kotruvesi	CV	Vaj	Pop.IKUA	Pop	1995
O13411	I bardhi i Krujës	CV	Vaj	Pop.IKUA	Pop	1995
O13412	Frank	CV	Vaj	Pop.IKUA	Pop	1995
O13413	I bardhi i Lezhës		Vaj	Pop.IKUA	Pop	1995
O135	ULLASTRA					
O1351	Ullastra		Nensh.far	Pop. IKUA	Pop	1995
O136	Arbequina			Spanja	2010	
O1361	Picual			Spanja	2010	
O1362	Manzanilla de Sevilla			Spanja	2010	
O1363	Nocellara Etnea			Italia	2010	
O1364	Carolea			Italia	2010	
O1365	Carotina			Italia	2010	
O1366	Chalkidiki			Greqia	2010	
O1367	Kallamon			Greqia	2010	
O1368	Konservolia			Greqia	2010	
O1369	Koroneki			Greqia	2010	
O1370	Bianchera			Sllovenia	2010	
O1371	Kushan			Shqipëri	2011	
O1372	Boç			Shqipëri	2011	
O1373	Sterbjak			Shqipëri	2011	
O1374	Karen			Shqipëri	2011	
O1375	Kallmet			Shqipëri	2011	
O1376	Ulliri i kuq			Shqipëri	2011	
O1377	Managjel			Shqipëri	2011	
O1378	Ulliri i zi			Shqipëri	2011	
O1379	Krisbi i Krujës			Shqipëri	2011	
O1380	K.V.186			Shqipëri	2011	
O1381	Micka			Shqipëri	2011	

* Në listën e kultivarëve të ullirit do të përfshihen edhe kultivarë të tjerë të importuar dhe të autorizuar nga ESHFF-ja deri në momentin e aplikimit.



ANEKSI 5

FORMULARI PËR MASËN 5

Qarku _____, Bashkia _____

Njësia administrative _____, Fshati _____

PROJEKTI I MBJELLJES

Për mbjelljen e sipërfaqes _____ ha

Specia: ullinj

Kultivari: _____

Periudha e realizimit të mbjelljes: | Gjashtëmujori i parë – 2019

☐

| Gjashtëmujori i dytë – 2019

☐

Aplikuesi/ Përfaqësuesi: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Adresa e aplikuesit: _____, tel./cel: _____

HARTUESI I PROJEKTIT: Ekstensionisti-AREB/QTTB _____
(emër, mbiemër, firmë)

Adresa: _____, tel./cel _____



1. PËRSHKRIMI I TERRITORIT KU DO TË ZBATOHET MBJELLJA

1.1 Zona kadastrale____, nr. kadastral/pasurisë____ emërtimi popullor i ngastrës:

1.2 Pjerrësia e ngastrës (%): 5 ☐
5–25 ☐
25–45 ☐
< 45 ☐

1.3 Drejtimi i ngastrës: Veri ☐
Jug ☐
Lindje ☐
Perëndim ☐

1.4 Përshkrimi i gjendjes hidrike të ngastrës/ngastrave: _____

1.6 Përshkrimi i tokës:

- ▶ Përbërja mekanike e tokës së ngastrës: _____;
- ▶ Përmbajtja e gurëve në tokë në %: _____;
- ▶ Thellësia e tabanit: e cekët____, mesatar____, e thellë____
- ▶ Thellësia e ujërave freatike: e cekët____, mesatar____, e thellë____

1.7 Vlerësimi agronomik për përshtatshmërinë e ngastrës për kultivimin e species_____:



1.8 Mënyra e ujitjes

☐

Ujitje me pika

☐Tradicionale (*Specifiko*) _____

1.9 Punimi i tokës:

☐

Plugim me traktor mbi ____ cm thellësi

☐

Diskim + branim/ frezim

☐

Nivelim sipërfaqësor i ngastrës

1.10 Disa të dhëna për praktikën e mbjelljes dhe të kultivimit:

- Sipërfaqia/sipërfaqet: _____
- Numri i bimëve/ha: _____
- Distancat e mbjelljes: _____ m x _____ m,
- Mënyra e kultivimit: ☐ Intensive (jo më pak se 400 bimë/ha)
, ☐ Tradicionale (jo më pak se 200 bimë/ha)



PROJEKTSKICA E NGASTRËS/NGASTRAVE
(Skica e ngastrës)

Në hapësirën bosh të kësaj faqeje skicohet plan vendosja e sipërfaqes së mbjellë me kufizimet dhe shënimet brenda e jashtë saj duke ju referuar elementeve të mëposhtme

<u>Brenda skicës:</u>	<u>Jashtë skicës:</u>
Rrjeti rrugor (rruga hyrëse dhe rrugët brenda ngastrës)	- Zona kadastrale
Rrjeti kullues dhe/ ose rrjeti antieroziv.	_____
Rrjeti ujitës, sipas rastit.	- Nr. kadastral/pasurisë _____
Ndërtesa të ndryshme që i shërbejnë prodhimit.	- Sipërfaqja gjithsej _____ ha,
Parcelimi i ngastrës.	- Sipërfaqja efektive që mbillet _____ ha,
Drejtimi i rreshtave.	- Kundrejtimi i ngastrës ndaj pikave të horizontit,
Planvendosja e specieve dhe varieteteve.	_____
	-
	Kufizimet _____

Ekstensionisti-AREB/Q'TTB _____

Data,më ____/____/2019



ANEKSI 5.1

FORMULARI PËR MASËN 5/1

Qarku _____, Bashkia _____

Njësia administrative _____, fshati _____

PROJEKTI

(Plotësimi i numrit të bimëve në ullishta të vjetra/degraduara)

Për mbjelljen e _____ Ha

Specia: ullinj, kultivari: _____

Periodha e realizimit të mbjelljes: Gjashtë mujori i parë – 2019

☐

Gjashtë mujori i dytë – 2019

☐

Të dhëna për:

Masivin e ullishtës:

- Emri popullor i masivit nëse ka, _____
- Zona kadastrale _____
- Sipërfaqja e masivit _____
- Kultivari ekzistues _____
- Mosha e ullishtës afërsisht në (vite) _____

Për ngastrën:

- Nr. kadastral/pasurisë (ngastrës) _____
- Numri ekzistues i numrit të bimëve/ha, në ngastrën tuaj: _____
- Numri i bimëve për tu plotësuar _____

Aplikuesi/ përfaqësuesi: (emër, mbiemër, firmë) _____

Adresa e aplikuesit: _____, tel./cel: _____

HARTUESI I PROJEKTIT:

Ekstensionisti-AREB/QTtB _____
(emër, mbiemër, firmë)

Adresa: _____, tel./cel _____



PROJEKTSKICA E MASIVIT TË ULLISHTËS DHE E NGASTRËS/NGASTRAVE
(Skica e ngastrës)

Në hapsirën bosh të kësaj faqeje skicohet plan vendosja e sipërfaqes së mbjellë me kufizimet dhe shënimet brenda e jashtë saj duke ju referuar elementeve të mëposhtme

Jashtë skicës:

- Zona kadastrale _____
- Nr. kadastral/pasurisë _____
- Sipërfaqja gjithsej _____ ha,
- Sipërfaqja efektive që mbillet _____ ha, _____%,
- Kundrejtimi i ngastrës ndaj pikave të horizontit, _____
- Kufizimet _____
- Data e plotësimit të këtyre të dhënave: _____

Ekstensionisti-AREB/QTTB



ANEKSI 6

FORMULARI PËR MASËN 6

Qarku _____ *Bashkia* _____

Nj. administrative _____, *fshati* _____

PROJEKTI

“Instalimi i sistemit të ujitjes me pika”

në ngastrën/bllokun e mbjellë me ullinj

me sipërfaqe: _____ Ha

Aplikuesi/përfaqësuesi: _____

(emër, mbiemër, firmë)

Adresa: _____, tel./cel _____

Ekstensionisti-AREB: _____

(emër, mbiemër, firmë)

Adresa: _____, tel./cel _____



TË DHËNAT KRYESORE

1. Të dhëna kryesore për vendndodhjen e ngastrës nr. kadastral/ pasurisë) _____

2. Sipërfaqja e ngastrës/ngastrave _____ Ha

3. Mosha: ullishtës:

4. Numri i bimëve/ ha për specien/speciet dhe gjendja aktuale e ngastrës së mbjellë:

5. Përshkrim i sistemit që do të instalohet:

- Burimi furnizimit me ujë (lloji, vendndodhja, largësia): _____

- Pompa/pompat (fuqia) _____

- Dozatori, filtri (tipi, kapaciteti) _____

- Tubacioni kryesor (përshkrimi), gjatësia, diametri, mënyra e montimit:

- Tubacionet shpërndarës në rreshtat (përshkrimi),diametri, mënyra e montimit:

7 Sprucatorët/pikator (përshkrim) (numri) _____

8 Ndërtesa/objekte brenda ngastrës (lloji, sipërfaqja) _____

**PROJEKTSKICA E NGASTRËS**

(Skica e ngastrës, vendosja e sistemit ujitës, kufizimet etj.)

Ne hapësirën bosh të kësaj faqeje skicohe: parcela, kufizimet, planvendosja e specieve, planvendosja e sistemit ujitës sipas elementeve të tabelave të mëposhtme:

Brenda skicës:

- Rrjeti rrugor, (rruga hyrëse dhe rrugët brenda ngastrës), dy vija paralele ngjyrë portokalli;
- Drejtimi i rreshtave
- Vendndodhja e burimit të furnizimit me ujë, ngjyrë blu
- Vendosja e tubacionit kryesor të furnizimit me ujë, vijë e trashë ngjyrë blu (tubacion i cili vendoset nën tokë)
- Vendosja e rrjetit shpërndarës, vijë e hollë e kuqe
- Drejtimi i tarracave nëse do të ketë të tilla

Jashtë skicës:

- Zona kadastrale _____
- Nr. kadastral/ pasurisë _____
- Sipërfaqja gjithsej _____ ha,
- Kundrejtimi i ngastrës ndaj pikave të horizontit, _____
- Kufizimet _____
- Data e plotësimit të këtyre të dhënave:

_____/_____/2019

Ekstensionisti/AREB: _____



ANEKSI 7. PJESA PËRSHKRUESE E PLANIT TË BIZNESIT

1..... *Historiku i aktivitetit ekzistues*

1.1 *Aktiviteti aktual i aplikantit*

1.2 *Struktura e pronësisë*

1.3 *Burimet njerëzore*

1.4 *Performanca e aktivitetit për tre vitet e fundit si dhe perspektiva e së ardhmes për biznesin në fjalë*

2..... *Projekti i investimit të ri të propozuar*

2.1 *Paraqitni me një përshkrim të shkurtër dhe një panoramë të përgjithshme të investimit të ri si dhe shpjegoni arsyet tuaja përse dëshironi të merrni përsipër projektin. Duhet të jepni informacione se si mendoni që të jeni të suksesshëm me këtë investim dhe modelin ku ju do të mbështeteni (p.sh. nëse keni një aktivitet në fermë/agrikulturor, si do ta integroni në investimin tuaj, përpunimin/degustim prodhimi, pjesëmarrje në aktivitete në fermë, vjelje, përfitueshmërinë e blerjes të makinerive/pajisjeve në raport me rentabilitetin/cilësinë etj.)*

3..... *Detajet financiare të projektit të ri të propozuar*

3.1 *Përmbledhje e kostove dhe financimit*



1. HISTORIKU I AKTIVITETIT EKZISTUES

1.1 Aktiviteti aktual i aplikantit

- *Përsbëruani shkurtimisht aktivitetin ekzistues, në lidhje me fermën apo njësinë agrikulturore.*

1.2 Struktura e pronësisë

- *Shpjegoni dhe paraqisni një listë të shoqërive që kanë lidhje pronësie me aktivitetin/ biznesin tuaj.*

1.3 Burimet njerëzore

- *Numri total i të punësuarve me kohë të plotë, si dhe numri i të punësuarve me kohë të pjesshme dhe sezonale.*
- *Numri i të punësuarve mbas investimit (nëse ka).*

1.4 Performanca e aktivitetit për tre vitet e fundit si dhe perspektiva e së ardhmes për biznesin në fjalë

- *Jepni përshkrime të nivelit të performancës financiare të kohëve të fundit.*



2. PROJEKTI I INVESTIMIT TË RI TË PROPOZUAR

- 2.1.** *Paraqitni me një përshkrim të shkurtër dhe një panoramë të përgjithshme të investimit të ri si dhe shpjegoni arsyet tuaja përse dëshironi të merrni përsipër projektin. Dubet të jepni informacione se si mendoni që të jeni të suksesshëm me këtë investim dhe modelin ku ju do të mbështeteni (p.sh., nëse keni një aktivitet në fermë/agrikulturor, si do ta integroni në investimin tuaj, pjesëmarrje në aktivitete në fermë, përfitueshmërinë e blerjes të makinerive/pajisjeve në raport me rendimentin/cilësinë etj.).*
- 2.2.** *Potenciali i tregut dhe plani i marketingut: Përshkruani vendndodhjen e fermës/njesisë agrikulturore tuaj. Përshkruani produktet dhe shërbimet që do të ofroni/përmirësoni, shumëllojshmërinë e tyre, aktivitetet që do të kryhen përmes këtij investimi.*



3. DETAJET FINANCIARE TË PROJEKTIT TË RI TË PROPOZUAR

3.1 Përmbledhje e kostove dhe financimit

- Lutemi të paraqisni një përmbledhje të totalit të kostove të investimit të propozuar bazuar në tabelat financiare. Analizoni të dhënat e tabelave financiare NPV dhe IRR dhe se si ato do të ndikojnë në investimin e ri.

KAPAKU I BIZNESPLANIT

Pasqyrat financiare

EMRI I PËRFITUESIT

INVESTIMI

DATA



ANEKSI 7.1 MODELI STANDARD I PLANIT TË BIZNESIT

SQARIME:

Plani i biznesit plotësohet (pjesa përshkruese dhe tabelat financiare), printohen, firmosen dhe vulosen (në qoftë se ka vulë) nga vetë aplikanti apo përfaqësuesi ligjor.

Dokumentet e printuara janë pjesë e dosjes së aplikimit dhe një kopje elektronike sipas këtyre formularëve tip të plotësuar dorëzohet me CD në dosjen e aplikimit.

Për çdo informacion shtesë, i cili nuk është parashikuar në këto formularë, por gjykohet si i rëndësishëm nga ana juaj, lutemi shtoheni.

Formularët tip të planit të biznesit mund të shkarkohen *online* nga faqja zyrtare e AZHBR-së: www.azhbr.gov.al

Përmbajtja:

KAPAKU I BIZNESPLANIT

OFERTAT

AMORTIZIMI

PASQYRA TË ARDHURA SHPENZIME

PASQYRA E FLUKSIT TË PARASË



Tabela 1: Kostot e investimit															
Nr.	Llojet e investimit	Njësia	Numri i njësive	Monedha	Çmimi për njësi (përfshirë TVSH dhe taksa të tjera) (në monedhën origjinale)	Vlera Totale (përfshirë TVSH dhe taksa të tjera) (në monedhën origjinale)	Kursi i Këmbimit	Vlera Totale (përfshirë TVSH dhe taksa të tjera) (në lekë)	TVSH dhe taksa të tjera (në lekë)	Vlera Totale pa TVSH dhe taksa të tjera (në lekë)	Shënime/Justifi kime kur çmimet e zërave në ofertën e përzgjedhur janë më të lartë se dy ofertat e tjera	Referencat	Vlera Totale me TVSH dhe taksa të tjera (në lekë)	Referencat	Vlera Totale me TVSH dhe taksa të tjera (në lekë)
I.	Ndërtime dhe rikonstruksione														
1															
2															
3															
4															
5															
6															
7															
8															
9															
10															
	Totali ndërtime dhe rikonstruksione							-	-	-			-		-
II.	Makineri dhe pajisje teknologjike														
1															
2															
3															
4															
5															
6															
7															
8															
9															
10															
	Totali makineri dhe pajisje							-	-	-			-		-
IV	Totali							0	0	0			0		0

Investimi Total	0
-----------------	---

**AMORTIZIMI**

Emri aplikantit

Amortizimi aktual Vlera (lekë për vit)

Tabela 2: Amortizimi i investimit/aktiveve të reja				
Nr.	Aktivi (emri)	Vlera e aktivit	Numri i viteve	Amortizimi vjetor
I.	Ndërtime dhe rikonstruksione			
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
II.	Makineri dhe pajisje			
1				
2				
3				
4				
5				
6				
III	Totali			0



PASQYRA TË ARDHURA SHPENZIME

Sqarime:

EBITDA

Fitimi para interesit, tatimit dhe amortizimit

EBT

Fitimi para tatimit

Tabela 1. Viti normal para investimit (mesatarja e 3 viteve të fundit)

Kategori	Vlerat vjetore					
	Njësité	Sasia	Çmimi	Vlera me TVSH	TVSH-ja	Vlera pa TVSH
Të ardhura nga shitjet						
<i>Rezultati total i shitjeve</i>						0
Kostot e prodhimit						



<i>Rezultati total i kostove</i>						0

<i>EBITDA</i>	0
Amortizimi	0
<i>EBT</i>	0
Tatimi mbi fitimin	0
Fitimi neto	0

Tabela 2. Viti normal i prodhimit pas investimit

Kategori	Vlerat vjetore				TVSH-ja	Vlera pa TVSH
	Njësitë	Sasia	Çmimi	Vlera me TVSH		
Të ardhura nga shitjet						
Rezultati total i shitjeve				0	0	0
Kostot e prodhimit						



<i>Rezultati total i kostove</i>				0	0	0
<i>EBITDA</i>						0
<i>Amortizimi</i>						0
<i>EBT</i>						0
<i>Tatimi mbi fitimin</i>						0
Fitimi neto						0

Tabela 3. Rezultati i ndikimit të investimit

Kategori	Vlerat vjetore		
	Vlera me TVSH	TVSH-ja	Vlera pa TVSH
Totali i shitjeve			
Totali i kostove të prodhimit			
<i>EBITDA</i>			
<i>Amortizimi</i>			
<i>EBT</i>			
<i>Tatimi mbi fitimin</i>			
Fitimi neto			0



EMRI I PËRFITUESIT

0

Tabela 1: Shfrytëzimi i kapacitetit

Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5

Tabela 2: Fluksi monetar		Faza e ndërtimit				
I. Kosto e projektit të investimit dhe granti		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5
Granti						
Kosto e investimit të projektit						
II. Impakti i investimit						
Kategoria						
Shitjet						
Kostot totale të prodhimit						
<i>EBITDA</i>						
Amortizimi						
<i>EBT</i>						
Tatimi mbi fitimin						
Fitimi neto						
Fluksi monetar	0					

NPV

0 LEK

IRR

#NUM!



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQESOR DHE RURAL

ANEKSI 8

FORMULARI I APLIKIMIT PËR INVESTIME 2019

Informacioni përgjithshëm mbi Aplikantin

1	EMRI/ATËSIA/MBIEMRI	
2	KARTA E IDENTITETIT	
3	STATUSI I APLIKANTIT	
4	SUBJEKTI	
5	NIPT-i	
6	RREGJISTRIMI NË QKB (DATA)	
7	ADRESA e Aplikantit / QARKU / BASHKI / FSHATI	
8	NUMËR KONTAKTI TEL/CEL	
9	EMAIL	

Të dhëna për investimin:

MASA E INVESTIMIT	
PËRSHKRIMI I SHKURTËR (LLOJI)	
VENDNDODHJA E INVESTIMIT QARKU/BASHKIA/FSHATI	
SHUMA TOTALE E INVESTIMIT	
GRANTI I KËRKUAR	

**MASA E MBËSHTETJES:**

7. Blerje e makinerive dhe pajisjeve për vjeljen e ullit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.
8. Blerje e makinerive dhe pajisjeve për prodhimin e vajit të ullit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt.
9. Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 10 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga Programi IPARD II.
10. Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga Programi IPARD II.

UNË I NËNSHKRUARI _____ PRANOJ SE, KUR NGA VERIFIKIMI REZULTON SE PËR MASËN E APLIKUAR NUK JANË PËRMBUSHUR KRITERET E PËRGJITHSHME DHE SPECIFIKE TË PËRCAKTUARA NË UDHËZIMIN NR. _____, DT. _____, APLIKIMI SKUALIFIKOHET.

FIRMË



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

ANEKSI 9

FORMULARI I KERKESËS PËR PAGESE 2019

1	EMRI/ATESIA/MBIEMRI ¹	
2	KARTA IDENTITETIT	
3	STATUSI I APLIKANTIT	
4	SUBJEKTI	
5	NIPT – i	
6	REGJITRIMINË QKR (DATA)	
7	QARKU/RRETHI/BASHK/FSHATI	
8	NUMER KONTAKTI TEL/CEL	
9	VENDNDODHJA E INVESTIMIT	
10	EMRI I BANKËS	
11	LLOGARIA BANKARE NË LEK	
12	IBAN	

MASAT E MBËSHTETJES:

- ☐ MASA 7. Blerje e makinerive dhe pajisjeve për vjeljen e ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt.
- ☐ MASA 8. Blerje e makinerive dhe pajisjeve për prodhimin e vajit të ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 (njëzet milionë) lekë për subjekt.
- ☐ MASA 9. Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 10 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 (pesë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga Programi IPARD II.
- ☐ MASA 10. Mbështetje për investime në agroturizëm kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga Programi IPARD II.

¹ Emri/Atesia/Mbiemri – të shënohen me gërma kapitale



Shënim: Ju lutemi përdorni këtë listë për të kontrolluar dokumentat që ju do të paraqisni në varësi të masës.

1. Situacionin e punimeve të kryera me faturën tatimore shoqëruar me librezën e masave (për ndërtim ose rikonstruksion); ☐
2. Faturën/faturat tatimore të blerjes së linjave/mjeteve/pajisjeve/materialeve, shoqëruar me specifikimet teknike, dhe vlerën ekonomike të elementëve përbërës; ☐
3. Akt zhdoganimit për pajisjet/materialet që vijnë nga jashtë vendit, shoqëruar me specifikimet teknike dhe vlerën ekonomike të elementëve përbërës; ☐
4. Çertifikatën e origjinës që vërteton se makineritë dhe pajisjet për vjeljen e ullirit/prodhimin e vajtit të ullirit janë prodhuar në Itali; ☐
5. Çertifikatën e Agrotunizmit; ☐
6. Transaksionin bankar dhe/ose SWIFT për të gjitha pagesat ndërkombëtare që vërteton transferimin e fondeve nga aplikuesi tek shitësi; ☐
7. Vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Tatimeve që vërteton se aplikanti ka pëmbushur detyrimet e tatimeve dhe kontributeve shoqërore, shëndetsore, etj. Ky dokument duhet të jetë lëshuar jo më shumë se 30 ditë nga data e dorëzimit të kërkesës për pagesë; ☐
8. Vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare, me firmë dhe vulë të njomë. ☐

Shënim: Ju lutemi të paraqisni listën e të gjitha faturave dhe të llogarisni totalin e parashikuar të shumës së shpenzimeve të pranueshme.

Nr	Përshkrimi i investimit	Sasia	Shuma në Lek me TVSH	Nr. Faturës	Data faturës	Emri furnitorit

Vlera e shumës së kërkuar për pagesë: _____ Lek
(_____)

50% e vlerës së shumës totale, por jo më shumë se:

- ☐ MASA 7 & 9 - 5 000 000 (pesë milionë) lekë
- ☐ MASA 8 - 20 000 000 (njëzet milionë) lekë
- ☐ MASA 10 - 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë

Emri i përfituesit

Nënshkrimi

Data

Adresa: Rruga "Muhamet Gjollësia", Nr. 56, Tiranë Tel: 042228318 web: www.azhbr.gov.al, email: info@azhbr.gov.al



ANEKSI 10. LISTA E 100 FSHATRAVE

Nr.	Qarku	Nr.	Bashkia	Fshati
I	Berat	1	Berat	Qafë Dardhë
				Roshnik
		2	Ura-Vajguore	Malas Breg
		3	Kuçovë	Kozarë
		4	Skrapar	Blezenckë
II	Dibër	5	Polican	Kapinovë
		1	Dibër	Radomirë
				Rabdish
		2	Mat	Bushkash
		3	Bulqizë	Zerqan
III	Durrës	4	Klos	Guri i Bardhë
		1	Durrës	Shetaj
				Radë
				Shënvllash
		2	Shijak	Gjepalaj/Maminas
IV	Elbasan			Metaliaj
		3	Krujë	Halilaj (Zgërdhesh)
		1	Elbasan	Shushiucë
				Gjinat
		2	Cërrik	Shtremen
		3	Belshë	Seferan
		4	Gramsh	Sotirë,
		5	Peqin	Pajovë
V	Fier	6	Librazhd	Stëblevë
				Dardhë
		7	Përrenjas	Rrajcë/Skënderbej,
		1	Fier	Pojan
				Libofshë
				Cakran
		2	Patos	Siqecë
		3	Rroskovec	Luar
VI	Gjirokastër	4	Lushnje	Krutje
				Ardenicë
		5	Divjakë	Goricaj
		6	Mallakastër	Hekal
		1	Gjirokastër	Dhoksat
				Zhulat
				Antigone
				Lazarat
		2	Libohovë	Libohovë e sipërme
				Nepravishtë
		3	Tepelenë	Nivicë
				Peshtan
		4	Memaliaj	Kalivaç,



		5	Përmet	Kosinë
				Leusë
		6	Këlcyrë	Malëshovë
		7	Dropull	Sotirë
VII	Korçë			
		1	Korçë	Drenovë/Boboshticë
				Voskopojë
				Dardhë
		2	Maliq	Zvirinë
		3	Kolonjë	Rehovë
				Borovë
		4	Pogradec	Lin
				Tushemisht
				Gurras
VIII	Kukës	5	Devoll	Arrëz
				Nikolicë
		6	Pustec	Zaroshkë
		1	Kukës	Shtiqën
				Shishtavec
IX	Lezhë	2	Has	Cahan
		3	Tropojë	Valbonë
		1	Lezhë	Fishtë
				Ishull-Lezhë
		2	Kurbın	Skuraj
X	Shkodër	3	Mirditë	Katund i vjetër
				Orosh
		1	Shkodër	Drisht
				Zogaj
				Theth
		2	Vau Dejës	Mjedë
				Kukël
		3	Pukë	Qelëz
		4	Fushë-Arrëz	Kryezi
XI	Tiranë	5	Malësi e Madhe	Razëm/Vrith
				Lëpushë
		1	Tiranë	Shëngjergj
				Shesh
				Pezë
				Pëllumbas
		2	Kamzë	Laknas
		3	Vorë	Prezë
				Marikaj
		4	Kavajë	Karpen,
		5	Rrogozhinë	Vilë Bashtovë
				German
		1	Vlorë	Kaninë
				Tragjas



XII	Vlorë			Zvërnec
		2	Himarë	Dhërmi/Vuno
				Kuç
				Lukovë
		3	Finiq	Mesopotam
		4	Selenicë	Ploçë/Amantia
				Drashovicë
		5	Sarandë	Çukë
		6	Konispol	Mursi
		7	Delvinë	Rusan

URDHËR**Nr. 112, datë 19.4.2019****PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM
KOMPETENCASH**

Në mbështetje të neneve 12, pikat 1 dhe 13, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 7, pika 3 e rregullores “Për veprimtaritë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, në mungesë të Kryetarit të Kolegjit

URDHËROJ:

1. Delegimin e plotë të kompetencave të kryetarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjyqtarit më të vjetër në moshë, z. Luan Daci, si vijon:

a) përgatit, thërret e drejton mbledhjen e anëtarëve;

b) përfaqëson Kolegjin e Posaçëm të Apelimit në marrëdhënie me të tretët;

c) ndërmerr të gjitha masat e nevojshme dhe të përshtatshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Kolegjit;

d) nënshkruan akte të tjera të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me përjashtim të vendimeve;

e) drejton shortin në rastet e përcaktuara në nenet 14, 15, 18, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

2. Delegimi i kompetencave të mësipërme është për periudhën 23 prill 2019 deri më 25 prill 2019.

3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet gjyqtari më i vjetër në moshë, z. Luan Daci.

4. Z. Luan Daci mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Natasha Mulaj

NJOFTIM**Nr. 5738, datë 17.4.2019****MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË
MARRËVESHJEJE DYPALËSHE ME
FILIPINET**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Filipineve, për heqjen e kërkesave për viza për mbajtësit e pasaportave diplomatike, të shërbimit dhe zyrtare, nënshkruar më 9 shtator 2013, ka hyrë në fuqi në datën 26 mars 2019.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Gazmend Barbullushi

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 1744, datë 11.3.2019, vendosi shpalljen e vdekjes së shtetasit Bahri Toçilla, i datëlindjes 16.6.1980, në datën 1.1.2000.

KËRKESË

Shtetasit Vera Sema, e datëlindjes 5.3.1948 dhe Marko Sema, i datëlindjes 18.4.1943, kërkojnë, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shpalljen të vdekur të djalit të tyre, shtetasin Kujtim Sema i datëlindjes 6.11.1975.

KËRKUES**Vera Sema****Marko Sema**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 448 lekë